


ANA E ERRET E PARTIZANEVE: MOBILIZIM ME FORCE, SEKUESTRIME E DJEGIE FSHATRASH

Zbardhen letra e Kolë Terovës dhe ankesa e një qytetari nga Dibra



[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR. 130

E MARTË 06-06-2017

www.shqiptarja.com

PRESIONI ELEKTORAL

U denoncuon për blerje votash, policia padi deputetit e drejtorit të LSI-së

Akuzohet Gledion Rehovica në bashkëpunim me Drejtorin e Spitalit të Beratit, Ildir Frashëri



LSI S'E FAL MILVA EKONOMIN PER SHKARKIMIN E LAZIMIT, I BEJNE KALLEZIM PENAL

Karabina kallëzim penal katër drejtuesve rajonalë të arsimit


▶ FAQE 4-5

PERGJIGJET E SAKTA

SKEMA E VLERESIMIT PER PROVIMIN E GJUHES SE HUAJ

Vëzhgim i rreptë për 40 mijë maturantë. Përgjigjet e testit brenda datës 20 qershor

▶ FAQE 16



LISTA 'BASHA'

KANDIDATET PA DIPLOMA DHE PROFESIONET E ÇUDITSHME

Zbulohet e shkuara e kandidatëve të PD, nga punëtorë të ujësjetës tek ata që s'kanë punuar asnjë ditë. Deklarojnë se kanë arsim të lartë, por fshehin llojin e diplomës

▶ FAQE 2-3

SONDAZHI PER ZGJEDHJET

REPORT TV E "PIEPOLI" SJELLIN SOT PARASHIKIMIN E PARE

▶ FAQE 9



DHUNIMI I TE MITURVE

ARRESTOHET NENA E DY VELLEZERVE AMERIKANE, USHTRONTE DHUNE

▶ FAQE 12

Të zhdukur prej 5 ditësh, u gjetën dje

Lista 'Basha'

Profesionet e kandidatëve, ja kush fsheh diplomat

Lista e çuditshme e PD, nga punëtorë të ujësjellësit tek kandidatë për deputetë që s'kanë punuar asnjë ditë

→ KANDIDATËT

Disa kandidatë nuk specifikojnë diplomën e shkollës së lartë, duke nënkuptuar se janë pa arsim të lartë, ndërsa shumë të tjerë nuk ka bërë asgjë në jetën e tyre para se të përfshiheshin në listën e Bashës, si kandidatë për ligjvënës së ardhshëm.

për të gjetur 140 kandidatë për të deputetë.

KANDIDATËT

Në Qarkun e Beratit, kandidati i PD, Bujar Hoxhaj, nuk specifikon llojin e diplomës së shkollës së lartë, ndërsa Monika Qosja, nuk ka bërë asnjë punë deri më sot, por si kualifikime përmend pjesëmarrjen në një konferencë stomatologjike.

Edhe lista për Qarkun e Dibrës dominohet nga të rinj që nuk thonë fakultetin që kanë kryer arsimin e lartë. Kandidati Afrim Pocesti rezulton specialist tek ujësjellësi Bulqizë, ndërsa Halil Jakimi anëtar i Këshilli Bashkiak Bulqizë dhe Jeton Kaloshi, inspektor Këshilli i Qarkut Dibër. Shumica e kandidatëve në Dibër nuk japin asnjë hollësi për arsimin e

lartë. Në Qarkun e Durrësit, PD ka kandiduar policë, juristë, agronomë, biznesmenë etj., ndërsa secili jep të dhëna rreth arsimit të lartë. Në Qarkun e Elbasanit, kandidati i PD, Ismail Cala, thotë se ka qenë drejtor dhe nëndrejtor burgu, drejtor konvikti, por nuk jep të dhëna për diplomën e arsimit të lartë. Ndërkaq, për kandidatin Mikel Tabaku nuk të dhëna as për arsimimin dhe as për punësimin.

KLEVIS BALLIU

Edhe kandidati për deputet i PD-së, Klevis Balliu ka dorëzuar CV-në e tij në KQZ. Djali i Fahri Balliut, botuesit të njohur të gazetës '55' në CV e tij, në vend të shkruajë Tiranë, vendlindjen e shënon,



→ LISTA E DIBRËS

Lista për Qarkun e Dibrës dominohet nga të rinj që nuk thonë fakultetin që kanë mbaruar arsimin e lartë. Afrim Pocesti rezulton specialist tek ujësjellësi Bulqizë, Halil Jakimi anëtar i Këshilli Bashkiak Bulqizë dhe Jeton Kaloshi, inspektor Këshilli i Qarkut Dibër.

'Tiran' dhe po kështu 'shtëpisë' e shkruan 'Shtëpis'. Klevis Balliu ka studiuar Shkencat Politike në Londër, por mesa duket Gjuhën Shqipe në Shqipëri e paska marrë me 'mik'. Si për ironi, ai është këshilltar i Presi-

dentit Bujar Nishani. Kjo është edhe puna e parë e tij zyrtare. Ndërkaq, deputeti Genc Pollo, i cili kandidon i dyti në listë në Qarkun e Fierit, në CV e tij, si eksperiencë në punë referon vetëm aktivitetin si deputet dhe ish-ministër në qeverinë e Partisë Demokratike. Pollo thotë se nuk ka bërë asnjë punë, për pos posteve që burrojnë nga angazhimi politik. Ndërsa, Myslim Murrizi, pjesë e listës fituese në Fier, thotë se ka punuar si avokat, në biznes privat, ka qenë ish-deputet, ka punuar në tatime, në KLSH dhe polici financiare. Ndërsa kreu i PR, Fatmir Mediu, pjesë e listës fituese të PD në Tiranë, nuk e ka ushtruar asnjë ditë profesionin si inxhinier për nxjerrjen e naftës.

PROFESIONET E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË TË PD SIPAS QARQEVE

| QARKU BERAT | |
|-----------------|---|
| Eduard Halimi | Avokat deputet ish-ministër drejtësie |
| Astrit Veliaj | Biznesmen deputet |
| Bujar Hoxhaj | Administrator nuk tregon llojin e diplomës ish-prefekt në berat |
| Myslim Haxhi | Administrator firme |
| Juvina Jani | Psikologe në gjykatën e beratit |
| Monika Qosja | Laborante stomatologe pa përvojë në punë |
| QARKU DIBËR | |
| Dhurata Çupi | Juriste deputete |
| Xhemal Gjunkshi | Usharak ish-shefi i shtabit |
| Edmond Isaku | Administrator kompanie nuk specifikon llojin e diplomës |
| Agron Qoku | Biznesmen ish-deputet |
| Denisa Vata | Përgjegjëse për kulturën bashkia mat nuk specifikon llojin e diplomës |
| Halil Jakimi | Anëtar i këshilli bashkiak bulqizë nuk specifikon llojin e diplomës |
| Jeton Kaloshi | Inspektor këshilli i qarkut dibër nuk specifikon diplomën |
| Afrim Pocesti | Specialist tek ujësjellësi bulqizë nuk specifikon diplomën |
| Bashkim Murati | Kirurg |

| QARKU DURRËS | |
|------------------|---|
| Oerd Bylykbashi | Jurist deputet |
| Fatbardha Kadiu | Doktor shkencash |
| Edi Paloka | Arsimimi inxhinier gjeofizik punë si gazetar deputet |
| Florjon Mima | Ekonomist deputet |
| Agron Duka | Agronom në shijak mësues në manzë deputet ish-ministër bujqësie |
| Vullnet Topalli | Polic |
| Enri Çeno | Avokat |
| Shkëlqim Fortuzi | Administrator kompanie |
| Dejana Burgija | Financiare në bankë |
| Everest Varaku | Inxhinier ndërtimi pa eksperiencë pune |
| Bujar Huqi | Agronom |
| Ardian Kokomani | Jurist |
| Helenida Sava | Inxhinier gjeodet |
| Alban Isteri | Administrator nëndrejtor i inuk durrës |
| Agron Loka | Biznesmen |
| Erzen Laçi | Polic |
| Blerim Vogli | Mjek |
| Krenar Rryçi | Jurist |
| Kujtim Gjuzi | Ekonomist |

| QARKU ELBASAN | |
|--------------------|---|
| Edmond Spaho | Ekonomist deputet |
| Endri Hasa | Ekonomist inxhinier elektronike |
| Luciano Boci | Pedagog prof/as. Dr. Deputet zv/rektor |
| Taulant Zeneli | Inxhinier ndërtimi |
| Arben Elezi | Mësues |
| Fitimatar Zekthi | Gazetar |
| Nada Tapija | Pedagoge |
| Blendi Himci | Pedagog |
| Kodhel Cala | Veteriner |
| Gavrosh Zela | Ekspert për mjedisin |
| Qani Xhafa | Inxhinier mekanik punon në autoshkollë |
| Armir Krasniqi | Jurist asistent avokat |
| Ibrahim Sako | Punon në zyrë juridike |
| Ismail Cala | Drejtor -nëndrejtor burgu drejtor konvikti nuk jep të dhëna për diplomën e arsimit të lartë |
| Loren Gllavina | Inxhinier pyjesh ish-drejtor i pyjores gramsh |
| Xhaferr Dushku | Mësues |
| Sindi Daiu | Ekonomiste |
| Vangjel Kallajxhiu | Avokat |
| Mikel Tabaku | Punësim privat s'ka të dhëna as për arsimin dhe as për punësimin |
| Arjan Karriq | Mësues |



Jetëshkrim i kandidatit për deputet (Curriculum Vitae)

Emëri: GENC
 Atësia: STEFAN
 Mbledhësi: POLLU
 Datë lindja: 07 PRILL 1963
 Vend lindja: TIRANË

Kandidat për deputet në zgjedhjet për Kuvendin 2017 në qarqun FIER
 propozuar nga PARTIA DEMOKRATIKE

Arsimi: LARTË
 Eksperienca në punë: 28 VJET DEPUTET, MINISTER
 Kualifikimi: LARTË

Jetëshkrim i kandidatit për deputet (Curriculum Vitae)

Emëri: KLEVIS
 Atësia: FAHRI
 Mbledhësi: SALLI
 Datë lindja: 23.08.1969
 Vend lindja: TIRANË

Kandidat për deputet në zgjedhjet për Kuvendin 2017 në qarqun KORÇË
 propozuar nga PARTIA DEMOKRATIKE

Arsimi: SHKENCA POLITIKE UNIVERSITETI RICHMOND NE LONDER
 Eksperienca në punë: KESHILLTAR I PRËSDENTIT TE REPUBLIKES / DREJTOR I SHITESIS BOUTESE 55
 Kualifikimi:

Aktivite shoqerore dhe politike:

Shënim:

- Arsimi, eksperienca në punë, kualifikimi dhe aktivitetet dhe detyrat e paditën nga më i vonshmi në më të hershmin;
- CV duhet të plotësohet dhe firmoset nga kandidati,
- CV silleet në KQZ në letër dhe elektronikisht në format për nga partia ose komiteti nismëtar.

QARKU FIER

| | |
|--------------------------|--|
| Enkelejd Alibeaj | Jurist ish-deputet ish-ministër |
| Genc Pollo | Deputet ish-ministër |
| Muslim Murrizi | Avokat biznes privat ish-deputet tatime klsh polici financiare |
| Luan Baci | Mësues avokat |
| Olsi Cukaj | Ka punuar në hotel rognor |
| Luljeta Sejko | Financiare |
| Dilaver Kamberaj | Biznes privat |
| Jakup Beqiri | Ekonomist |
| Shkëlqim Krasniqi | Ushtarak |
| Aurora Koroveshi | Administratore tekstil s'ka të dhëna për diplomimin |
| Altin Malokaj | S'ka të dhëna për diplomimin pa eksperiencë pune |
| Elizabeta Kurti | Mësuese |
| Pandeli Tole | Jurist biznes privat |
| Almer Toska | Gazetar |
| Klement Cela | Mësues |
| Ferdinant Cobo | Biznes privat |
| Ermal Sefa | Administrator firmë private |
| Endri Jaupaj | Jurist |
| Elvis Pisku | Inxhinier ndërtimi |
| Zamira Mernica | Universiteti justiniani i |
| Fogert Hoxha | Stomatolog |

QARKU TIRANË

| | |
|--------------------------|---|
| Orjola Pampuri | Pedagoge psikologe kliniciste |
| Rudina Hajdari | Pjesë e stafit të kongresit amerikan zyra e komisionit të jashtëm |
| Grida Shqima | Lektore shkencat sociale |
| Albana Vokshi | Fakulteti i inxhinierisë master në shba për politikën ekonomike deputete |
| Jorida Tabaku | Pedagoge deputete |
| Halim Kosova | Mjek gjinekolog |
| Gent Strazimiri | Jurist deputet |
| Fatmir Mediu | Inxhinier për nxjerrjen e naftës deputet |
| Dashamir Shehi | Doktor shkencash në ekonomi deputet |
| Gerti Bogdani | Shkenca kompjuterike deputet |
| Fuad Haxhiymeri | Ekonomist biznesmen |
| Blendi Sulaj | Jurist |
| Flamur Hoxha | Sipërmarrës |
| Fatbardh Plaku | Agronom |
| Dorjan Teliti | Ekonomist / jurist |
| Besnik Fucia | Ekonomist |
| Shkelqim Hoxha | Ekonomist |
| Ahmet Prenci | Polici arsimimi për ekonomi dhe drejtësi |
| Korab Lita | Ekonomist / jurist |
| Mirela Dragoni | Mjete pedagoge |
| Barbara Doda | Studente |
| Enkelejda Sallaku | Pedagoge |
| Ndriçim Dushku | Mësues |
| Erion Piciri | Lektor |
| Genci Gjylsheni | Mësues |
| Fisnik Qosja | Jurist |
| Lisander Hoxha | Drejtor drejtorie bashkia tiranë |
| Lulzim Omuri | Universiteti politeknik s'ka të dhëna për natyrën e degës dhe të eksperiencës në punë |
| Artur Roshi | Inxhinier për sizmologjinë |
| Hysen Kadiu | Jurist |
| Dashnor Visha | Drejtoria e burgjeve master e drejtë publike |
| Indrit Hoxha | Nëpunës bashkia tiranë s'ka të dhëna për diplomimin |
| Besmira Petriti | Uriste |
| Ana Kadillari | S'ka të dhëna për diplomimin asistente e zv/ministrit të brendshëm |
| Erald Shulla | Ish-specialist bashkia tiranë |
| Ina Haxhija | Shkenca politike specialiste bashkia tiranë |
| Ares Ypi | Gazetar tek '55' |
| Halit Valteri | S'ka të dhëna për diplomimin sektori privat |
| Oriona Kurtesi | Gjendja civile |
| Sokol Ruka | Inxhinier mekanik |
| Ylber Valteri | Avokat |
| Kostaq Papa | Jurist |
| Selami Jenishehri | Mësues matematike |
| Majlinda Halilaj | S'ka të dhëna për diplomimin |
| Besnik Troplini | S'ka të dhëna për diplomimin |
| Zana Prela | Psikologe |
| Muharrem Doda | S'ka të dhëna për diplomimin punën dhe kualifikimet |

QARKU KORÇË

| | |
|----------------------------|--|
| Valentina Duka | Dekane e fakultetit histori filologji |
| Ervin Saljanji | Jurist |
| Hekuran Hoxhalli | Inxhinier ndërtimi |
| Klevis Balliu | Shkenca politike londër këshilltar i presidentit |
| Andrea Mano | Mësuesi biologji-kimi ish-prefekt korçë |
| Ligoraq Karamelo | Mësues |
| Fatmir Guda | Mësues gazetar |
| Kristiano Koçibelli | Avokat |
| Soela Myrtollari | Ekonomiste |
| Arlind Çaçani | Jurist / ekonomist |
| Marta Male | Financë-kontabilitet pa eksperiencë pune |
| Andi Përmeti | Pedagog |
| Erdion Maçolli | Jurist |
| Koçi Tahiri | Agronom |
| Gazmir Troja | Administrator s'ka të dhëna për diplomimin |

QARKU KUKËS

| | |
|---------------------|--|
| Flamur Noka | Onkolog deputet ish-ministër |
| Isuf Çela | Veteriner |
| Alban Zeneli | Deputet |
| Miftar Dauti | Sigurimet shoqërore has s'ka të dhëna për diplomimin |

QARKU LEZHË

| | |
|-------------------------|--|
| Aldo Bumçi | Pedagog deputet ish-ministër |
| Lindita Metaliaj | Juriste |
| Andon Frrokaj | Inxhinier ndërtimi vlerësues pasurie |
| Preç Zogaj | Mësues gazetar poet ish-deputet |
| Martin Biba | Oficer garda e republikës |
| Luigj Gjergji | Mësues |
| Enkelejda Rica | Privat arsimiti i lartë por s'ka të dhëna për diplomimin |
| Klajti Reçi | Arsimi i lartë por s'ka të dhëna për diplomimin |
| Albert Loçi | Inxhinier gjeodezie |

QARKU SHKODËR

| | |
|------------------------|---|
| Romeo Gurakuqi | Mësues lektor |
| Izmira Ulqinaku | Arkitekthe |
| Lorenc Luka | Jurist ish-kryebashkiak |
| Bardh Spahia | Ish-zv/ministër i shëndetësisë |
| Nard Ndaka | S'ka të dhëna për diplomimin ish-sekretar i bashkisë vau i dejës deputet ish-ministër |
| Gjok Ulledaj | Pedagog deputet |
| Anton koka | Polic biznesmen |
| Prellë Gjoni | Punon pranë oshe |
| Isuf Meta | Master shkencor s'ka të dhëna për profesionin dhe eksperiencën |
| Benardeta Syku | Pedagoge |
| Arvit Bushati | Inspektor d.T.Sh |
| Ardit Çybyli | Zv/drejtor bordi i kullimit shkodër nuk specifikon diplomimin |
| Denis Fani | Ekonomist |
| Aurel Markaj | Mësues |
| Denisa Meçi | Nuk specifikon diplomimin s'ka eksperiencë pune |
| Orjeta Shkambi | Mësuese |
| Nikolin Staka | Biznesmen s'ka të dhëna për diplomimin |
| Zef Shtjefni | Avokat |

QARKU GJIROKASTËR

| | |
|-------------------------|---|
| Tritan Shehu | Mjek pedagog ish-deputet ish-ministër |
| Roland Bejko | Pedagog |
| Koca Barka | Inxhinier minierash |
| Besnik Aliaj | Arkitekt urbanist |
| Qamil Xhelili | Administrim publik |
| Mimoza Como | Arsim |
| Fatjona Dhimitri | Juriste |
| Arjan Kasaj | Agronom |
| Vjollca Luke | Pa eksperiencë në punë s'ka të dhëna për diplomimin |

QARKU VLORË

| | |
|----------------------------|---|
| Agron Shehaj | Ekonomist |
| Nadire Mecorapaj | S'ka të dhëna për diplomimin specialiste për programin e zhvillimit |
| Vangjel Dule | Mësues anglishteje |
| Arben Ristani | Jurist deputet ish-kreu i qz avokat ish-gjyqtar |
| Dashamir Tahiri | Biznesmen s'ka të dhëna për llojin e diplomës |
| Adriatik Alimadhi | S'ka të dhëna për llojin e diplomës ish-zv/ministër |
| Hariz Mema | Kontabilist |
| Matilda Qurku | Juriste |
| Lorenc Danaj | Pedagog |
| Skerdilaid Sulozëqi | Gazetar |
| Florenc Spahiu | Arsimi i mesëm biznesmen |
| Jolio Dine | Ekonomist |
| Ervis Meco | Administrator |

LSI nuk e fal Ekonomimin për shkarkimin e Lazimit, kallëzim penal

Drejtori i Postave u shkarkua për angazhim në fushatë, ministrja: Ma jep ligji të drejtën

ESIONA KONOMI
TIRANE

Lëvizja Socialiste për Integrim nuk e ka toleruar ministren e ekonomisë, Milva Ekonomi, pasi kjo e fundit shkarkoi një nga njerëzit më të besuar të Metës nga posti i Administratorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare, Majlind Lazimi. Pasi kallëzoi të shtunën 3 ministra dhe zëvendëskryeministren për valën e shkarkimeve të zyrtarëve, kryesisht në radhët e LSI-së, me argumentin e përfshirjes në fushatë, dje, vetë Lazimi i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, ku ka ngritur padi ndaj ministres Ekonomit. Sipas Lazimit, shkarkimi i tij ishte politik, pa motiv dhe i paligjshëm, ndaj ka kërkuar pavlefshmërinë e tij.

LAZIMI

“Nuk ka asnjë motivacion dhe arsye në atë shkarkim. Besoj se është e nevojshme që



Majlind Lazimi

secili të ndjekë argumentet, unë të miat i kam depozituar në prokurori, dhe në Gjykatën Administrative për ta shpallur urdhrin të pavlefshëm. Nëse do kishte diçka ligjore që unë kam shkelur do ishte e ndershme për të gjithë të jepej arsyeja, nuk kam asgjë të shkruar veç një

LAZIMI

“Nuk ka asnjë motivacion dhe arsye në atë shkarkim. Besoj se është e nevojshme që secili të ndjekë argumentet, unë të miat i kam depozituar në prokurori, dhe në Gjykatën Administrative për ta shpallur urdhrin të pavlefshëm.”

urdhri për lirim nga detyra, pa motivacion, argumentim. U hap si lajm në media për përfshirje në fushatë, por nuk ka asgjë për këtë, duhet të jepet arsye logjike, qoftë edhe jo ligjore”, -tha ai. Sipas tij, që nga largimi i tij, Posta ka pësuar dëme të mëdha dhe po ashtu, edhe shteti dëm ekonomik e financiar.

EKONOMI

Ministrja e Ekonomisë Milva Ekonomi ka reaguar në lidhje

me shkarkimin e drejtorit të Përgjithshëm të Postës, Majlind Lazimi, duke thënë se është në zbatim të detyrave që i jep ligji. “Kam të drejtën që më jep ligji për emërime dhe shkarkimi edhe për shoqëritë anonime. Jam në zbatim të detyrave që më jep ligji”, është shprehur ministrja.

SHKARKIMI

Lazimi i cili konsiderohet si një nga njerëzit më të besuar të Ilir Metës, sot Sekretar i Përgjithshëm për Ekonominë në LSI, u shkarkua nga grupi i Taskë-Forcë, e drejtuar nga zv/kryeministrja teknike e PD, Ledina Mandija, për shkelje elektorale dhe ushtrim presioni ndaj punonjësve për interesa elektorale. Vetë Lazimi e quajti këtë vendim si sulm politik, ndërsa sfidoi, duke kërkuar prova që vërtetojnë se ai ka shkelur ligjin elektorale. Pas shkarkimit Majlind Lazimit nga posti i Drejtorit të Përgjithshëm të Postës, një valë shkarkimesh u bënë në Ministrinë e Drejtësisë, frenat e



EKONOMI

“Kam të drejtën që më jep ligji për emërime dhe shkarkimi edhe për shoqëritë anonime. Jam në zbatim të detyrave që më jep ligji”, është shprehur ministrja e Ekonomisë, Milva Ekonomi.

së cilës për 4 vite i ka mbajtur LSI. Gazmend Bardhi, ministri teknik e Drejtësisë shkarkoi dhe kallëzoi në Prokurori 8 zyrtarë të lartë të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sistemit të Burgjeve dhe Zyrës

së Përmbarimit, për përfshirje në fushatë zgjedhore. LSI reagoi me një deklaratë për shtyp duke e cilësuar këtë, ‘si fushatë të hakmarrjes nga marrëveshja e errësirës PD-PS ndaj partisë së tyre’.

Shkarkimet në administratë, LSI letër Nishanit, Ramës dhe OSBE

Vasili: “LSI u la jashtë diskutimeve për Task-Forcën. Po komprometojnë procesin zgjedhor”

Shkarkimet e ditëve të fundit në administratën publike, kanë shqetësuar jo pak Lëvizjen Socialiste për Integrim. Pas reagimeve zyrtare ku nuk munguan akuzat në adresë të PS dhe PD se po bëjnë komplot ndaj LSI, kryetari i kësaj force politike, Petrit Vasili, i është drejtuar përmes një letre presidentit Bujar Nishani, kryeministrit Edi Rama, kryeprokurorit Adriatik Llalla, kreut të

KQZ, Klement Zguri, si dhe përfaqësuesve të misionit të OSBE/ODIHR në Tiranë. LSI shpreh shqetësimin e saj për shkarkimet e drejtorëve, ndërsa kërkon të merren masa ndaj kësaj situatë. Sipas LSI, ndryshimet në administratë janë bërë pa asnjë motiv, ndërsa thekson se po komprometohet ecuria e procesit zgjedhor. “Shkarkimet pa asnjë motiv e provë, duke abuzuar me hapësirat antiligjore të krijuara nga ky vendim, po komprometojnë ecurinë normale të procesit zgjedhor, po instalojnë një klimë absurde abuzimi dhe shpërdorimi me pushtetin, e cila ka përkeqësuar klimën politike dhe ka ushqyer indinjatën e thellë të opinionit publik për këto veprime. Veprime të tilla duhet të ndalen menjëherë”, thuhet në letër. Vasili thekson se ministrat e LSI në kabinetin qeveritar janë lënë jashtë diskutimeve për ngritjen e Task Forcës me qëllim monitorimin e veprimtarisë së ministratës. “Një vendim kaq i rëndësishëm nuk i është nënshtruar asnjë

TË SHKARKUARIT DERI MË TANI

| | | |
|-----|------------------------|--|
| 1. | Jetnor Krakulli | Drejtor i burgut, Fier |
| 2. | Eduart Kurti | Drejtor i burgut, Lezhë |
| 3. | Ahmet Bala | Drejtor i burgut, Rragozhinë |
| 4. | Fatjon Kurti | Drejtor i burgut, Burrel |
| 5. | Fatjon Fana | Drejtor i burgut 313 |
| 6. | Ani Dyrmishi | Drejtor hipoteke, Durrës |
| 7. | Adriana Shehu | Drejtor hipoteke, Sarandë |
| 8. | Surin Hoxha | Drejtor i Përmbarimit Gjyqësor Durrës |
| 9. | Majlind Lazimi | Drejtor i Përgjithshëm i Postës Shqiptare |
| 10. | Marisa Kaçori | Drejtoreshë e Shërbimit të Punësimit, Tiranë |
| 11. | Edmond Ndou | Drejtor i Hipotekës, Shkodër |
| 12. | Albana Allushi | Drejtoreshë e RTSH-së së Gjirokastrës |
| 13. | Granit Kurmekaj | Drejtor i burgut të Tropojës |
| 14. | Sajmira Laçi | Drejtoreshë e Shëndetit Publik, Pukë |
| 15. | Haris Ngjeqari | Drejtoreshë e Postës, Berat |
| 16. | Eljo Lazaj | Inspektor, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |

debati qeveritar dhe mundësisë së shprehjes së opinionëve nga Ministrat, por është hartuar e miratuar në mënyrë tërësisht

të njëanshme, ku specifikojnë anëtarët e kabinetit qeveritar, përfaqësues të LSI, kanë qenë jashtë diskutimit dhe janë vënë




Petrit Vasili

para faktit të kryer, duke u çuar një vendim qarkullues, të cilit nuk i njihen as autorët dhe as ata që kanë dhënë opinionet”, -thuhet në letërën e Vasilit. LSI shpreh rezerva edhe për marrëveshjen e 18 majit Rama-Basha, duke insistuar për transparencë përpara opinionit publik. “Asnjë marrëveshje politike nuk mund të dalë mbi ligjet dhe të justifikojë instalimin e një qeverisjeje policore e që dhuron të drejtat e liritë

themelore të garantuara nga kushtetuta e ligji. Një situatë e tillë absurde që ka rrënuar besimin e qytetarëve të shteti duhet të marrë fund tani, pasi koha e errësirës ka përfunduar dhe vetëm transparencë e plotë është ajo që pret çdo shqiptar”, -thuhet ndër të tjera në letërën e Petrit Vasilit drejtuar krerëve të institucioneve, OSBE-së si dhe misionit ndërkombëtar të vëzhguesve të zgjedhjeve.

Masat Zhvillohet mbledhja e parë e Task-Forcës së Ledina Mandisë

Dje u zhvillua mbledhja e parë e Task-Forcës (grupit ndërinstitucional) së ngritur me Vendimin e Këshillit të Ministrave në 1 janar 2017 "Për marrjen e masave dhe marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor



Ledina Mandija

për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017". Kjo Task-Forcë ka në përbërje të saj titullarë të ministrive të ndryshme si dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura, konkretisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Prokuroria e Përgjithshme, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Avokati i Popullit. Task-Forca do të mbledhet periodikisht dhe gjatë mbledhjeve të saj do të diskutohen çështje dhe problematika që lindin gjatë procesit zgjedhor. Lidhur me këto problematika Task-Forca pritet të miratojë masa dhe rekomandime të ndryshme të cilat do t'u dërgohen për ndjekje ministrive dhe organeve të tyre të varësisë me qëllim garantimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme. "Dëshirojmë të kujtojmë që gjatë orarit zyrtar të punës çdo pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore për një parti politike ose kandidat është e ndaluar për çdo punonjës të administratës shtetërore nëpunës civil, administrativ apo me kontratë pune. Së fundmi, inkurajohen titullarët e ministrive dhe institucioneve të varësisë të vepron në përputhje me rregullimet e VKM-së më sipër dhe më gjerë të kuadrit ligjor në fuqi dhe të pandikuar nga presione të çdo lloji, me qëllim kryerjen e zgjedhjeve lira, të ndershme dhe demokratike të denja për një vend anëtar të NATO-s dhe që aspiron të pranohet me të drejta të plota në Bashkimin Evropian", -thuhet në njoftimin për shtyp.

NË FOTO:
Ministrja e ekonomisë,
Milva Ekonomi

Fushata, kallëzim penal katër drejtuesve rajonalë të arsimit

Ministrja teknike e arsimit, Karabina:
Kemi prova për të gjitha rastet

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kallëzuar penalisht 4 drejtues rajonalë të arsimit, me akuzën e përfshirjes në fushatë elektorale. Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbi bazën e informacioneve të mbledhura ka evidentuar raste të pjesëmarrjes të punonjësve në pozicione drejtuese të cilët në kundërshtim me ligjin, janë angazhuar në aktivitete të fushatës zgjedhore në kundërshtim me përcaktimet ligjore. "Për të gjithë rastet për të cilat ka fakte të dokumentuara, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka depozituar sot me datë 05.06.2017, pranë organit të Prokurorisë në rrethet përkatëse dhe duke informuar edhe Prokurorinë e Përgjithshme, për drejtuesit, si më poshtë: Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Librazhd, znj. Fatbardha Qatja; Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Gramsh, z. Xhevit Dyrmishi; Përgjegjësi i Zyrës Arsimore Bulqizë, znj. Bedrie Manjani dhe Drejtori i Drejtorisë Arsimore Rajonale Lezhë, z. Bardhok Pula.

Ministria e Arsimit dhe Sportit shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar institucionalisht me organet kompetente duke vlerësuar çdo provë të depozituar në trajtimin me profesionalizëm të gjitha rasteve të përfshirjes së paligjshme të administratës shtetërore në fushatën zgjedhore", -thuhet në njoftimin për



Mirela Karabina

shtyp të ministres Mirela Karabina. Vendimi vjen në zbatim të ndryshimeve të fundit të Kodit Penal, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 23 maj 2017, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave datë 01 qershor 2017 "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017" është duke monitoruar në vijimësi të gjithë punonjësit e administratës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve të varësisë.

U denoncuan për blerje votash, policia kallëzon deputetin e LSI

Gledion Rehovica në bashkëpunim me
Drejtorin e Spitalit të Beratit, Ildir Frashëri



Gledion Rehovica

ESIONA KONOMI
TIRANE

Policia e Shtetit ka kallëzuar penalisht deputetin e LSI-së së Beratit, Gledion Rehovica dhe drejtorin e spitalit të këtij qyteti, Ildir Frashëri, pas një denoncimi për blerje votash dhe presion ndaj administratës së këtij institucioni. Në njoftimin për shtyp të Policisë së Shtetit, por edhe të zëvendëskryeminstres Ledina Mandija, nuk saktësohen se cilat janë rolet e zyrtarëve, edhe pse thuhet se ata kanë bashkëpunuar me punonjës të tjerë të spitalit të Beratit duke konsumuar veprën e korrupsionit aktiv në zgjedhje. Në njoftim thuhet se materialet ju referuan prokurorisë së përgjithshme, dhe jo prokurorisë së qarkut Berat, çka do të thotë se dyshimet ndaj deputetit Rehovica, të cilin mund ta hetojë vetëm Prokuroria e Përgjithshme, janë të forta. Policia nuk ka bërë hetime për këtë çështje, por i është referuar vetëm dëshmisë së një qytetari, dhe do të jetë organi i akuzës, ai që do të vijojë procedurat për regjistrimin apo jo të hetimit penal.

NJOFTIMI I POLICISË

Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Policinë e Shtetit dha këtë njoftim për shtyp dje në mbrëmje. "Sot në datë 05.06.2017, Sektori për Hetimin e Korrupsionit në Drejtorinë për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Departamentin për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimit e Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, mbi bazën e një denoncimi, filloi procedimin penal

për shtetasin I.F, pasi duke qenë në funksion publik të Drejtorit Rajonal të Spitalit Berat, në bashkëpunim me disa punonjës të këtij spitali dhe deputetin e zonës G.R., kanë konsumuar elementet e veprës penale të "Korrupsionit aktive në zgjedhje" dhe "Përdorimi i funksionit publik në veprimtari politike ose zgjedhore", vepra penale të parashikuara nga nenet 328 dhe 328/a të Kodit Penal.

Materialet procedurale i kaluan për kompetencë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, për veprën penale të "Korrupsionit aktiv në zgjedhje" dhe "Përdorimi i funksionit publik në veprimtari politike ose zgjedhore", vepra penale të parashikuara nga nenet 328 dhe 328/a të Kodit Penal.

VEPRA PENALE

Neni 328, Korrupsioni aktiv në zgjedhje

Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë në kundërshtim me ligjin, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.

NENI 328/A


Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore

Pjesëmarrja e një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore në shërbimin civil ose në një funksion jopolitik në administratën shtetërore, në kundërshtim me ligjin, në aktivitetet ose fushatën zgjedhore, të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose organizimi për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose kërkesa drejtuar shtetasve, nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor, për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje, për të mbështetur ose jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje, ose për të votuar në një mënyrë caktuar, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, në kundërshtim me ligjin dhe qëllimin e detyrës, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.



Ildir Frashëri

Debat

POLIÇAN



tezat, por tha se të rinjtë po mashtrohet, pasi nuk mund t'i nxjerrë askush tezat e vërteta,

Në kulmin e debatit mes së Arsimi, Lindita Nikolla, vetë kryeministri Rama ka pranuar se të rinjtë maturantë, votues për herë të parë po tentohet të joshen duke ju ofruar tezat e provimeve. Rama nuk përmendni se kush janë partitë që ofrojnë

Teza e Maturës, Rama pranon: Po ju ofrojnë teza të rreme

të cilat, sipas Ramës, janë të sekretuara. "Sot në mëngjes dëgjova me trishtim një lajm që maturantëve po u ofrohet kopja e tezave të provimeve në shkëmbim të parave dhe kartave të identitetit të familjarëve të tyre. Dua t'u them se kjo është një mashtrim sepse tezat janë të sekretuara që

askush nuk mund t'i nxjerrë në pazarin e votave. Dua t'i them atyre që gjenden përpara kësaj oferte mashtruese që jo vetëm ta refuzojnë, por edhe të kuptojnë se mjafton një ofertë e tillë që shkel dinjitetin e prindërve tuaj për t'u bashkuar edhe më të vendosur për Partinë Socialiste", -u shpreh

kreu i PS. Këto deklarata Rama i bëri në Poliçan, nga ku kërkoi një mandat të plotë për PS pas 25 Qershorit. Në fjalën e tij, Rama tha se ditën e zgjedhjeve qytetarët do të marrin një vendim të rëndësishëm për skuadrën që duhet të drejtojë punët e vendit. "Më 25 Qershor duhet të shkojmë

në zgjedhje jo si tifoze partish, por si shqiptarë që duam të gjithë së bashku që vendi të ndahet nga një histori e gjatë dhe mundimshme e shtetit të copëtuar në republika partish, që në emër të forcave që kanë për shkak të votës ndajnë zyrat e shtetit mes tyre", -tha Rama në Poliçan.

PS-LSI tjetër sherr

Lindita Nikolla: LSI përgjegjëse për shitje diplomash

Kejdi Mehmetaj përgjigjet "flakë për flakë": Zysh, diplomën e bleve apo e more dhuratë?



ESIONA KONOMI
TIRANE

Në ditën kur maturantët zhvilluan provimin e parë të detyrueshëm të gjuhës së huaj, dhe kur u përhap teza se partitë po shesin tezen në kërkim të votës, debati mes dy aleateve kryesore të qeverisë, PS dhe LSI u ashpërsuar pikërisht për arsimin e lartë. Të dielën, deputetja e LSI-së, Kejdi Mehmetaj, ishte shprehur se ripërsëritja e këtij sistemi pranimesh në universitet, që ajo e quan klientelist, do të thellonte dështimin. Në reagimin e saj, ish-ministrja e Arsimi, Lindita Nikolla i bëri thirrje deputetes së LSI-së të lerë pas militantizmit dhe të jetë më transparente, duke akuzuar LSI si përgjegjëse për shitjen e diplomave. Mehmetaj ka reaguar përsëri "flakë për flakë" duke e pyetur ministrin nëse diplomën e saj të masterit në një universitet privat, e kishte të blerë, apo dhuratë.

NIKOLLA

"Habitem që kandidatë të LSI sillen si opozitarë. S'ka përligje më të mirë se ky status, për kërkesën tonë që, PS duhet të drejtojë e vetme timonin e reformave në të katër vitet e ardhshme. Ky status është vërtetimi që, forcat e tjera në koalicion, njëren dorë

e mbajnë në timonin e qeverisë dhe tjetren e përdorin për të goditur forcën kryesore që nxit reformat në vend," -shkruan Nikolla në Facebook ku i kujton LSI dhe bashkëqeverisjen me PD-në. Në këtë pikë ajo thekson marrëdhëniet e LSI me Universitetet që shisnin diploma. "A ke diçka për të thënë për bashkëpërgjegjësinë

tuaj në hapjen e universiteteve private piramidale si kërpuha deri në 2013-ën? Si i ka pasur marrëdhëniet forca juaj me universitetet e mirënjohur për shitje diplomash? Vitin që shkoi u regjistruan në universitet publike 5% më shumë studentë dhe në universitetet private 27% më pak se përpara reformës. Ku e mbështet tërë

atë batore balte moj vajzë?", shkruan Nikolla në statusin në Facebook. Ajo i jep këshilla Mehmetajt dhe pse e akuzon se nuk e lexuar fare Ligjin për Arsimin e Lartë. "Ti je një vajzë e re, dhe nuk ka dëm më të madh që i bëhet kauzës së të rinjve në politikë, sesa kur dikush, që i janë dhënë të gjitha mundësitë për të kontribuar,

zgjedh politikën e baltës. Dy fjalë për reformën dhe ligjin, që me shumë gjasa ende nuk e ke lexuar, megjithëse e ke votuar vetë. Nuk ke dëgjuar edhe se çfarë ekspertët dhe përfaqësuesit e KE thonë për atë që ti e quan "katrahurë". Informohu paraprakisht edhe për aktet nënligjore. Dhe në fund një këshillë Kejdi: Mos e bëj gabimin që bëre një vit më parë, duke shkaktuar panik tek maturantët. A ke menduar një çast se sa keq ke ndikuar tek ata me daljet e tua vend e pa vend? Të njëjtën gjë po tenton të bësh edhe këtë vit me statusin tënd. Nuk meritohen votat kështu! Gënjeshtër nuk mund të jetë kurrë një shans për të gjithë", -përfundon Nikolla.

kishit argument t'u jepnit përgjigje maturantëve", -thuhet në fillim të reagimit të Mehmetaj, e cila më pas rendit se LSI ka luajtur rol të madh në sensibilizimin e të rinjve për "katrahurën që ju kurdisët në kurriz të maturantëve" dhe akuzon ministrin se ligjin ja kanë bërë oligarkët. "Unë kam qenë disa herë në zyrën tuaj për të diskutuar për ligjin dhe me keqardhje po konstatoj sërish, se ju si ish ministre ende nuk e kuptoni ligjin dhe pasojat e tij. Ju nuk keni si ta dini çfarë kam thënë në komision apo parlament, sepse ju vetë as nuk keni qenë në komision dhe as keni marrë pjesë në hartimin e ligjit të arsimi të lartë, për të janë kujdesur oligarkët e arsimi privat me të cilët ju dhe të tjerë kanë lidhur interesat në kurriz të të rinjve shqiptarë" -thotë Mehmetaj. Ajo hedh dyshime mbi diplomën e dytë të ministres në një universitet privat. "Cdo akt yni për reformën në arsim ka ngecur pikërisht në zyrën tuaj, ku ndodhet e varur në mënyrë të dukshme edhe diploma juaj nga një universitet privat, e ngjashme me diplomat e disa kolegëve tuaj në grupin parlamentar. Më mirë se unë, ju duhet ta dini nëse diplomën tuaj e keni dhuratë apo e keni blerë ashtu sikur na akuzoni në statusin tuaj", -tha Mehmetaj. Deputetja e LSI-së thotë se drejtorët e shkollave po fshijnë mungesat e maturantëve në këmbim të votës.

"Matura"

Tabaku: Mos u gënjeni me ata që sot zihen, heshtën para një viti

Deputetja demokrate Jorida Tabaku përmes një statusi në Facebook ka ironizuar replikat në distancë mes PS dhe LSI në ditën e provimit të parë të maturantëve. Pasi ka uruar të gjithë maturantët në këtë ditë të rëndësishme të edukimit të tyre, ku mbyllin një cikël të rëndësishëm e çelin një tjetër, Jorida Tabaku i fton të rinjtë që të mos pranojnë të gënjen sërish nga ata që i gënjen edhe një vit më parë. Tabaku u kujton se ata që një vit më parë heshtën për ligjin e arsimi të lartë sot janë në luftë të hapur mes tyre, duke iu referuar këtu PS e LSI. "Mos lini që gënjeshtër të atyre që premtuan dhe pastaj u fshehën në ditët




e nevojës t'ju gënjejnë sërish. Të gjithë ju e mbani mend se si një vit më parë ato që sot janë në një luftë të hapur mes tyre heshtën për Ligjin e Arsimi të Lartë. Ne kemi nevojë për gjithsecilin prej jush jo vetëm që të ndërtojmë të ardhmen e sigurt por edhe për të rikthyer shpresën në këtë vend. Ne kemi nevojë për besimin tuaj që të mund të zbatojmë atë për të cilën jemi zotuar; Arsimim të Lartë për të gjithë, infrastrukturë më e mirë mësimore dhe zhvillim profesional. Historia jonë na tregon se në ditë të vështira, njerëzit janë bashkuar për t'i zgjidhur ato, historia e atyre që u përpoqën për të mirën dhe luftuan për një të ardhme më të mirë se sa e djeshmja", -thotë Jorida Tabaku.

MEHMETAJ

"E nderuar zysh Lindita, Kur gënjeshtër të kthehet në patologji, jo vetëm nuk ofron shanse, por të nxjerr humbës në përbaljen e radhës! Më lejo të të kujtoj si fillim se unë nuk jam "moj vajzë", pasi nuk jam vajza juaj që studion në Francë dhe as vajza e korridoreve të Partisë Socialiste që pret urdhërat e shefave për të vepruar, goftë për vendimet mbi jetën personale apo atë familjare. Nuk jam "moj vajzë", jam deputete e Kuvendit të Shqipërisë, që të ka kërkuar shumë herë llogari dhe që nëse nuk e kujton, disa herë më kërkove të tërheq interpelancën e fundit që kërkova me ju, pasi nuk

Rama: Po të isha zgjedhur President, s'do dilja në fushatë

"Kyça gojën kur LSI hiqte gratë socialiste nga puna dhe i kërcënonte që të ndryshonin parti"



Thellohet hendeuku mes Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, duke zbehur shpresat për një koalicion të mundshëm paszgjedhur. Pas akuzave të ndërsjella në nivel deputetësh dhe ministrash, kryeministri Edi Rama ka shigjetuar mbrëmë Ilir Metën dhe LSI. Në "Top Story", Rama tha se po të ishte zgjedhur president nuk do të dilte në fushatë si Ilir Meta. "Ai nuk është akoma president i ngarkuar për të mbrojtur unitetin kombëtar. Është president i zgjedhur. Unë nuk do ta bëja, por është zgjedhja e tij", pohoi Rama. Shefi i qeverisë shtoi se nuk ka një koordinim mes PS dhe PD për të sulmuar LSI. "Kjo është çështja e tyre, nuk është problemi im. PD është në një fushatë të dëshpëruar dhe mesa unë arrij të kuptoj ky është fundi i një cikli për PD. Përpjekja për të paraqitur në këtë fushatë vizionin e një republike të re, me një program që me një llogari të thjeshtë do ta çonte borxhin mbi 100 për qind dhe me 5 skuadra që në 5 qarqe që nuk kanë asnjë grua, tregon se PD u thotë grave dhe vajzave në këto qarqe që në republikën e re nuk ka vend për t'ju përfaqësuar. Kjo është dramatike. Pas gjithë atyre

Pengesat

"Është rezultati më shkatërrimtar i koalicioneve. Të gjitha partitë kanë hedhur këtë valle. Kjo do të marrë fund. Kësaj i jepet fund me votë duke e bërë Partinë Socialiste që të jetë e pashantazhueshme, e cila duhet të ketë timonin vetëm."



hapave që janë hedhur në drejtim të barazisë dhe pasi kemi një ligj për këtë kemi një

parti që pretendon republikën e re dhe ha pesë gjopa për këtë", tha Rama. Ndërkaq, më herët, Rama ka pohuar nga Berati se ka heshtur kur LSI hiqte gratë socialiste nga puna. "Unë jam dëshmitar dhe kam kyçur gojën kur gratë socialiste hiqeshin nga puna nga partnerët tanë në koalicion, që i shantazhonin për të ndërruar parti", tha Rama.

RAMA: PARTITË E VOGLA SHANTAZHOJNË PËR PUSHTET

Nga Ura Vajguore, në Qarkun e Beratit, ku çeli fushatën elektorale të Partisë Socialiste, kryeministri Edi Rama, kërkoi sërish votën e qytetarëve për të qeverisur i vetëm pas 25

Për Metën

"Ai nuk është akoma president i ngarkuar për të mbrojtur unitetin kombëtar. Është president i zgjedhur. Unë nuk do ta bëja, por është zgjedhja e tij".

qershorit. Rama sulmoi partitë e vogla kur u shpreh se shantazhojnë për pushtet, ndërsa nuk japin asnjëherë llogari për atë që marrin. "Po nuk u hoq parcelizimi, po nuk u hoqën gardhet e partive, po nuk u hoqën të drejtat e partive abuzive për të vendosur kush do bëjë çfarë në shtet e kemi shumë të vështirë të bëjmë

gjënë që u duhet njerëzve. E kemi shumë të vështirë të marrim më të mirët, sepse vjen dikush i diplomuar, me pasion, me integritet, me eksperiencë dhe i thuhet jo se në atë detyrë, atë sektor e drejton dikush tjetër. Është rezultati më shkatërrimtar i koalicioneve. Të gjitha partitë kanë hedhur këtë valle. Kjo do

të marrë fund. Ne kemi parë vetë se si Policinë e Shtetit e kemi larguar nga partitë", -tha Rama. Ai ftoi qytetarët të besojnë me votë PS-së në mënyrë që të qeverisë e vetme. "Kësaj i jepet fund me votë duke e bërë Partinë Socialiste që të jetë e pashantazhueshme, e cila duhet të ketë timonin vetëm", -u shpreh Rama.



Taulant Balla në Peqin: Denonconi çdo presion për votën

Drejtuesi politik i PS për Qarkun e Elbasanit, Taulant Balla në vazhdën e takimeve elektorale u ndal në Peqin ku zhvilloi një bashkëbisedim me banorët e Njësisë Administrative Pajovë nga ku theksoi rëndësinë e zgjedhjeve të 25 Qershorit dhe nga ku u bëri thirrje qytetarëve të denoncojnë çdo presion për votën nga cilado palë të vinte ai. "Të dashur miq, vota e 25 Qershorit është shumë e rëndësishme. Ajo as nuk duhet shitur, as nuk duhet blerë. Kush do guxojë të blejë votën e

popullit në 25 Qershor do ketë probleme me drejtësinë, sepse drejtësia pas 25 Qershorit nuk është ajo që ka qenë deri para se të fillonte procesi i Vettingut. Java që vjen është një javë shumë e rëndësishme ku komisionet mbyllin fazën e parë të Vettingut. Sot kemi legjislacionin më të fortë në Europë që të parandalojë shitblerjen e votës, të parandalojë presionin e çdo zyrtari, denonconi këdo që vjen tu bëjë presion për votën. PS as ka blerë e as do të blejë ndonjëherë vota.

Prandaj është partia më e votuar në Shqipëri, ndaj do të jetë fituese në 25 Qershor dhe fituese me diferencë, jo 71, por 75 mandate do të ketë PS sepse ka popullin me vete. Unë po e shkel cep më cep Elbasanin dhe nuk kam parë kurrë mbështetje më të madhe se kjo, sepse Shqiptarët e thjeshtë e kuptojnë fare mirë se kush është drejtimi i historisë dhe edhe populli i Peqinit do të jetë pjesë e drejtimit të duhur për Shqipërinë", -tha kryesuesi i listës së PS-së për Elbasanin. Balla

u ndal më tej në tregun e dikurshëm të Pajovës, i cili nuk ekziston më dhe fermerët nuk kanë një vend ku të tregtojnë prodhimet e tyre. Duke theksuar domosdoshmërinë e tregut, Balla tha se "përveç pazarit do të ndërtohen edhe pikat e grumbullimit, të pajisura edhe me të gjithë pajisjet frigoriferike për ruajtjen e prodhimeve. Një metodë që përdoret edhe në Lushnjë, duhet patjetër të ndërtohet edhe në Peqin, një nga zonat bujqësore më prodhuese në qarkun e Elbasanit", -tha Balla.

Çuçi: Sot, 220 mijë hektarë tokë vaditen rregullisht

Kandidati i PS-së: Në 2 vite, pastrohen dhe vaditen të gjitha tokat bujqësore

Kryesuesi i Partisë Socialiste në qarkun Gjirokastrë Bledi Çuçi zhvilloi sot një seri takimesh duke filluar në pazarin e qytetit e Këlcyrës për t'u shtrirë më pas në Ballaban, Goricë

dhe Picar. Gjatë vizitës në Këlcyrë, ai iu shpreh tregtarëve se pas përfundimit të projektit për sheshin në qendër të qytetit dhe shetitores, do të vijohet më tej me projektimin dhe ndërtimin e një pazari dinjitoz për t'i ofruar të gjitha kushtet një prej pazareve më të njohura të jugut të Shqipërisë. Më tej, ai vazhdoi turin e takimeve në Ballaban dhe Goricë, ku vuri në dukje se 220 mijë hektarë tokë vaditen rregullisht, 2 herë më shumë se gjatë 25 viteve të fundit: "Bujqësia ishte tërësisht e braktisur në 25 vite. 125 mijë hektarë tokë vaditeshin në 2013 dhe vetëm falë reformës territoriale e cila i dha mundësi financiare bashkive të ishin



aktorë kryesorë në punë komunitare, e kemi çuar në 240 mijë hektarë. Brenda 2 viteve të mandatit të ardhshëm, ne nuk do të lëmë asnjë centimetër tokë të punueshme në Shqipëri pa vaditje", -tha Çuçi. Në fund të fjalës së tij, ish-ministri për çështjet vendore premtoi se gjatë mandatit të dytë do të hiqet TVSH për inputet kryesore bujqësore duke sjellë një lehtësim 30 milionë dollarë për fermerët. "Do të ndërmarrim nisma në parlament për heqjen e TVSH për inputet bujqësore. Janë 30 milionë dollarë që paguhen sot nga fermerët si rezultat i këtij tatimi ndaj në mandatin tonë të ardhshëm kjo taksë do të zerohet për inpute si fidanë, farëra dhe

pesticide duke filluar që nga buxheti e 2018", - Çuçi. Ai shpali pikat e programit për bujqësinë, ku renditi: 232 mln dollarë më shumë financime për bujqësinë, nga këto, 100 mln USD investime në rrugë dytësore me Bankën Botërore dhe 71 mln EUR nga fondet IPARD (BE). Ai shtoi se "përfundon pastrimi i kanalave kulluese dhe vaditëse në të gjithë Shqipërinë. Hiqet TVSH për inputet bujqësore si plehrat kimike, pesticidet, farërat, fidanet. Përfundon procesi i shpërndarjes së certifikatave të pronësisë për tokat bujqësore. Përfundon pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse në të gjithë Shqipërinë"-ka thënë ndër të tjera, Bledi Çuçi.

Basha-Metës: Bjeri sa të duash daulles, s'ka shi për SHPK

"Kjo qeveri i ka ndarë shqiptarët në të djathtë e të majtë, jugorë dhe veriorë"

Në hapjet e fushatës elektorale në Kukës, kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha tha se prej 5 ditësh fushatë, Edi Rama e Ilir Meta nuk kanë lënë gjë pa bërë për të tërhequr vëmendjen nga ekonomia e rënduar e vendit. Duke nisur nga video ku Meta i binte daulles në Kukës, Basha shprehet se tashmë nuk ka mbetur gjë tjetër, vetëm që njëri t'i bjerë daulles dhe tjetri të kërcejë. Kreu i opozitës gjithashtu ka thumbuar Metën se mund t'i bjerë sa do të dojë daulles, por për SHPK-në e tij nuk ka për të pasur më shi. "Ja kam thënë para 5 ditësh që s'do lejë gjë pa bërë vetëm ta heqë vëmendjen nga papunësia, po bën karikatūra me elefantë e me zebra, basketboll... Se ai tjetri erdhi me daulle dhe e patë besoj, ky tjetri do kërcejë se s'i ka ngel gjë tjetër tani, estrade...Kjo është e vërteta e dhimbshme dhe cinike e një njeriu që nuk guxon të hapë gojën për papunësinë. Le t'i bjerë sa të dojë Ilir Meta daulleve, s'ka për të pasur më shi për tokat e SHPK-së. Tokat e SHPK-së s'kanë për të pasur më shiun e pushtetit, kështu që le t'i bjerë sa të dojë daulleve", tha Basha.

AKUZA QEVERISË

Basha akuzoi qeverinë se ka lënë në harresë Veriun dhe se ai do të jetë kryeministri që do të bëjë një Shqipëri. "Sa herë jemi takuar në këto katër vite, lajtmotivi është se s'ka para, ekonomia është në pikiatë dhe kuksianët janë harruar e diskriminuar. Kjo qeveri i ka ndarë shqiptarët në të djathtë e të majtë, jugor



Lulzim Basha në Kukës

e verior që i ndan si të ishte pushtues jo qeveri që duhet të mendojë për gjithkënd. Unë do i jap fund diskriminimit krahinor. Në Republikën e Re, jug e veri, lindje, perëndim do të jenë një. Keq i ka punët Rama dhe i shmanget përballjes kudo. Kjo sepse s'ka asnjë bilanc pozitiv apo fjalë të mbajtur. Sa i përket Kukësit as nuk paska ardhur edhe pse rrugën ja kemi bërë. Rruga ka mbaru, kandidatet e Ramës kanë mbetur në

BUJQËSIA

"Në bazë të modelit Trump unë do të mbyll traun për prodhimet bujqësore që konkurrojnë padrejtësisht fermerët shqiptarë. Ekonomia e fortë sjell të nesërmen e sigurt. Çdo koncesion do të zhbëhet që ditën e parë që marr punën si kryeministër".

Mirditë. Ky është kapitullimi i Ramës në Kukës dhe flamur i bardhë i Republikës së Vjetër të kapitulluar", tha Basha.

BASHA NË TROPOJË

Kreydomkрати Lulzim Basha ka vijuar turin elektorale në Tropojë. Në takimin që pati me banorë dhe simpatizantë të zonës Basha kryetari i Partisë Demokratike u shpreh se bazuar në modelin Trump do të mbyllë traun për prodhimet bujqësore që

Fushata

Duma një fashioniste përballë njerëzve të varfër

Fushata elektorale e secilit prej kandidatëve për deputet, në më të shumtën e rasteve u nxjerr atyre anën pozitive e njerëzore përballë qytetarëve me halle shumë. Ndërsa secili përpiqet të jetë sa më i përlulur e njerëzor me qytetarët, teksa shihen të shtrëngojnë duart apo të ulen e të bashkëbisedojnë me ta, e madje të qajnë hallet e shumta të tyre, kjo situatë më së paku duhet të reflektohet edhe në një veshje sa më të thjeshtë të kandidatëve. Për këtë nuk ka ndonjë kod veshje, apo rregull të shkruar, por vetë fakti që shkojnë për tu kërkuar votën i bën kandidatë më të përlulur, pasi janë ata që kërkojnë diçka në këmbim të një të ardhmeje më të mirë. Pa paragjykuar bashkëbisedimin e Grida Dumës me banorë të njësisë numër një në Tiranë, zonë kjo, që nuk është në krye të listës si zonë e pasur, madje përkundrazi aty gjen njerëz me halle shumë, Grida Duma shfaqet e stiluar dhe e kuruar deri në detaj. Ajo duket si një fashioniste e vërtetë që performon përballë ose në krah të njerëzve që i shtrëngojnë dorën e presin me shumë për një të ardhme më të mirë nga ajo? Por a është kjo veshja që duhet të përcjellë një kandidatë që shkon për t'u "lypur" votëbesimin qytetarëve? Kjo mbetet në gjykimin e secilit prej jush...



konkurrojnë padrejtësisht fermerët shqiptarë. Basha tha se 25 qershori duhet të jetë rrugëzgjdhja që duhet t'i japë fund politikave diskriminuese antikomëtare ndaj veriut e Tropojës. "109 milionë euro subvencione për fermerët shqiptarë. Financim i drejt-përdrejtë që do kthehen në mirënie zhvillim rural dhe punësim. Në bazë të modelit Trump unë do të mbyll traun për prodhimet bujqësore që konkurrojnë padrejtësisht

fermerët shqiptarë. Ekonomia e fortë sjell të nesërmen e sigurt. Çdo koncesion do të zhbëhet që ditën e parë që marr punën si kryeministër. Sistemi arsimor publik nga kopshti në maturë do të ofrojnë drekën falas për çdo fëmijë të Republikës së Re të paguar nga buxheti i shtetit. Fëmijët shqiptarë s'do enden rrugëve por edhe pas dreke të bëjnë aktivitete pashkolllore deri në orën 16:00", tha Basha.

ZGJEDHJET / "ASKUSH NUK E NDRYSHON DOT FATIN E PD"

Patozi: PD e dënuar të fitojë edhe pse i ndryshuan ngjyrën

Deputeti demokrat, Astrit Patozi, i cili nuk u përfshi në listat e kandidatëve të Lulzim Bashës, komenton "mungesën" e blusë tradicionale të PD-së në këtë fushatë zgjedhore. Por për Patozin, kjo nuk është humbje për PD-në, pasi sipas tij, fati politik i Partisë Demokratike nuk përcaktohet nga ngjyra e simboleve. "Ka një shqetësim jo të vogël tek njerëzit që janë mëshuar prej 26 vjetësh me shenjat e forta dalluese të Partisë Demokratike, të cilat nuk po i gjejnë kësaj radhe në fushatë. Dikush ma tha se ishte çuditur shumë dhe kur kishte hasur nëpër rrugët e Gjirokastrës të rinj të veshur me bluza blu që shkruanin "Rilindje" dhe të

ASTRIT PATOZI

"Partia Demokratike është krijuar për të udhëhequr, që nga dita e themelimit të vet, e derisa të jetojë, ndaj asaj i konsiderohet humbje vendi i dytë. Dhe kjo vlen, jo vetëm për 25 qershorin, por për të gjitha zgjedhjet në Shqipëri, sa herë ato të mbahen".

tjerë kuqebardhë me stampën e "Republikës së Re" në gjoks. Natyrisht, që nuk më ha fare merak për "balilat" e Edi Ramës, që për të ardhur deri këtu kanë përshkuar një rrugë të gjatë, mbushur plot me eksperimente dhe të papritura, në ndjekje të shijëve të udhëheqësit. Por edhe për sa na takon, mendoj se nuk ka vend për habi, dhe aq më pak për dekurajim.

Sepse Partia Demokratike nuk është një ndërtesë apo disa seli, nuk është një flamur dhe as një logo, e aq më pak një fanellë e ngjyrosur, edhe pse të gjitha këto kanë vlerën dhe rëndësinë e tyre. Ajo nuk është një njeri, as një grup i vogël individësh, dhe kursesi një polifoto apo libër llogarie. Partia Demokratike është shumë më tepër se kaq", thotë Patozi. Ai sht-

on se Partia Demokratike është mbi të gjitha frymë dhe shpirt, është shpresë dhe motivim, është krenari dhe përgjegjësi, është devocion dhe përkushtim. "Partia Demokratike është historia dhe e ardhmja e gati gjysmës së shqiptarëve, por edhe arsyeja e ekzistencës së pushtetit dhe opozitës për më shumë se çerek shekulli në këtë vend. Partia Demokratike është krijuar për të udhëhequr, që nga dita e themelimit të vet, e derisa të jetojë, ndaj asaj i konsiderohet humbje vendi i dytë. Dhe kjo vlen, jo vetëm për 25 qershorin, por për të gjitha zgjedhjet në Shqipëri, sa herë ato të mbahen. Është bekimi dhe mallkimi, që shoqëron gjithmonë ata që janë



Astrit Patozi

"dënuar" për të qenë fitues. Ndaj nuk ka vend fare për pezmatim. Demokratët dhe votuesit e së djathtës duhet

të ndjehen të qetë sot. Askush nuk e ndryshon dot fatin dhe destinin e Partisë Demokratike", shkruan Patozi.

Report Tv e "Piepoli" sjellin sot sondazhin e parë të zgjedhjeve

Kompania lider në Itali, në 2015 parashikoi fitoren e Veliajt

Sondazhi i parë profesional për rezultatin e zgjedhjeve të 25 qershorit do të publikohet sot në Report Tv nga "Instituto Piepoli", kompania lider në tregun e sondazheve në Itali. Më në fund, më 25 qershor do të votohet dhe për herë të parë partitë do të hyjnë në vetme në garë. Kush do ta fitojë sfidën e madhe elektorale? Dhe kush do të jetë kryeministri i ardhshëm? Mezi pret ta mësosh? Në të Report TV të ndihmojmë për ta ditur i pari. Report TV, në bashkëpunim me Institutin Piepoli, institucioni më i vjetër dhe më i famshëm i sondazheve në Itali, do të nxjerrë çdo javë një sondazh me parashikimin e votimit. Instituto Piepoli, i cili i vetmi gjeti një muaj para se të shpallej, rezultatin e zgjedhjeve vendore të vitit 2015, rikthehet në Shqipëri, për të parashikuar se ç'do të ndodhë me votimin e 25 qershorit.

SONDAZHI NGA KOMPANIA LIDER NË ITALI

"Instituto Piepoli" është themeluar nga Nicola Piepoli, 82-vjeçari që prej më shumë se gjysmë shekulli ka realizuar matje të opinionit publik përpara çdo zgjedhje të përgjithshme apo lokale të mbajtur në Itali. Një ndër sondazhet e fundit politike të realizuar nga ky grup ishte ai për referendumin e ndryshimeve kushtetuese të propozuar nga ish-Kryeministri Renzi në dhjetor 2016. "Piepoli", në bashkëpunim me televizionin shtetëror "RAI" parashikoi një rezultat prej 42% pro dhe 58% kundër, ndërsa në publikimin e "exit poll" pas zgjedhjeve e

"Piepoli"

"Instituto Piepoli" është themeluar nga Nicola Piepoli, 82-vjeçari që prej më shumë se gjysmë shekulli ka realizuar matje të opinionit publik përpara çdo zgjedhje të përgjithshme apo lokale të mbajtur në Itali.



korrigjoi këtë rezultat në 41% me 59%. Rezultati final lëvizi nga parashikimet me vetëm 0,1%, duke qenë 40,9% pro dhe 59,1% kundër. "Piepoli" ishte gjithashtu i pari që parashikoi fitoren e befasishme të Bashkisë së Romës dhe disa bashkive të tjera të mëdha nga lëvizja "Cinque Stelle" në 2016-n. Aktualisht, ky grup është duke bashkëpunuar rrjetin "RAI", duke nxjerrë në mënyrë të vazhdueshme projeksione për zgjedhjet vendore që zhvillohen në disa zona të Italisë brenda këtij muaji, në datat 11 dhe 25 qershor. "Instituto Piepoli", përveç zgjedhjeve të përgjithshme, prej disa dekadash është i punësuar për të bërë sondazhe të përjavshme për matjen e popullaritetit të

qeverisë italiane, pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur në kabinet. Metodën e përdorur nga profesionistët e grupit "Piepoli", si dhe mënyra e tyre e sofistikuar në përzgjedhjen e kampionit nga i cili del rezultati, i kanë mundësuar këtij grupi që të arrijë rezultate të shkëlqyera, duke qenë në 99% të rasteve brenda marshit të gabimit prej 2,5%. Pasi ka punuar me shumë parti dhe liderë politikë, shumë televizioneve që masin audiencën e tyre, kompani që realizojnë kërkime tregu dhe pas disa dhjetëra përvojave në matjet e popullaritetit të zgjedhjeve jashtë vendit, "Instituto Piepoli", në bashkëpunim me "Report tv" është duke realizuar të parën matje të saktë të popullaritetit që kanë partitë politike në vend.

'PIEPOLI' PARASHIKOI REZULTATIN PËR VELIAJ NË TIRANË

Besueshmëria e sondazhit "Piepoli" u vërtetua me zgjedhjet vendore të 2015-ës, ku për Tiranën parashikoi rezultatin real që ishte fitorja e Erion Veliajt. Nisur nga kjo sondazhi i "Piepoli" pritet të parashikojë fituesin e zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit. Në këtë datë zhvillohen zgjedhjet më të pazakonta në 20 vitet e fundit, ku tre forca politike pretendojnë se do të marrin 71 mandate.



ZGJEDHJET

Romana Vlahutin: Presionet për të votuar, të papranueshme

Ambasadorja e BE mesazh zgjedhësve

Ambasadorja e Bashkimit Evropian, Romana Vlahutin, nga Shkodra, ka theksuar se procesi zgjedhor në Shqipëri është shumë i rëndësishëm për të ardhmen e vendit ndaj u ka bërë thirrje votuesve të mos pranojnë asnjë presion qoftë edhe nga familjarët e tyre. Vlahutin, në takimin që pati me shoqërinë civile, tha se komuniteti ndërkombëtar po planifikon monitorimin e zgjedhjeve ndërsa është duke vëzhguar lëvizjet në administratë apo nëse ka abuzime me transaksionet e parave. "Çdo lloj presioni apo transaksioni mbi blerjen e votës me para në dorë apo favor tjetër, duhet refuzuar. Ju si përfaqësues të shoqërisë civile keni përgjegjësi më të madhe për të raportuar e monitoruar këto abuzime. Zgjedhjet janë përgjegjësi thelbësore e qytetarëve. Çdo qytetar duhet të jetë vigjilent për çdo element që tenton të abuzojë me procesin. Ne si komunitet ndërkombëtar po planifikojmë të monitorojmë zgjedhjet. Përparësi kemi në monitorimin e lëvizjeve të parave nëse ka abuzime si dhe lëvizjen e administratës. Do të ketë edhe një fushatë ndërgjegjësuere. Në fokus do të jenë



Romana Vlahutin në Shkodër

qytetaret të cilët do të pyeten nëse kanë parë që shitet vota apo ka korrupsion. Zgjedhjet janë për qytetaret dhe ju nuk keni vetëm detyrë të votoni por keni përgjegjësi edhe për raportim. Zgjedhjet parlamentare janë tepër të rëndësishme pasi përcaktojnë qeverinë e ardhshme, ka të bëjë me të ardhmen 4-vjeçare të vendit", është shprehur Vlahutin.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST CONSULTING SERVICES

Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2)

Consulting Service For

Local Consultant

Advisory support for Public Relation and Communication of Project activities

AL-IPS2-P129332-IC-CS-17-04.07

ALBANIA

Project: Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2)

Project ID: P129332

Assignment Title: Advisory support for Public Relation and Communication of Project activities

Ref. No: AL-IPS2-P129332-IC-CS-17-04.07

The Government of Albania has received financing in the amount of 3,815,107 EURO, equivalent from the World Bank toward the cost of the Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2) Project.

The IPS 2 Project will support the Government of Albania in further strengthening the implementation of the Integrated Planning System (IPS), which links strategic policy planning with the budget planning and public financial management more broadly. Main beneficiaries of this project are the Ministry of Finance (MoF) and the Department of Development and Foreign Aid (DDFA).

Due to the involvement of several key stakeholders and execution of a number of activities in parallel, there is a need for effective awareness and communication of IPS 2 ongoing activities, organization of joint events to share the developments and progress, develop a communication campaign to closely monitor and promote the achievements of project implementation. To support for effective communication of ongoing project activities and demonstration of rapid results, the DDFA, will hire a local individual Consultant (further on referred to as the Consultant).

The main objective of this assignment is to assist the DDFA for preparation, development and implementation of an effective communication plan and campaign related to integrated programmes and project activities and their impact on the life of Albanian citizens, and demonstrating rapid results on focusing on the awareness increase on the benefits of IPS 2 ongoing activities.

The Central Finance and Contracting Unit in the Ministry of Finance of Albania invite eligible Consultants to indicate their interest in providing the Services.

Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The qualifications required are:

- Master degree in journalism, public or international relations, marketing, and communications.
- Not less than 5 years of practical experience in developing Communication Plans/ Strategies/ Campaigns for projects related to public sector and/or private sector.
- Proven experience with communication projects. Proven ability to communicate project issues with high ranking government officials, and to resolve key issues quickly, will be essential. (proven experience will consist in Reference Letters/Copies of contracts)
- Extensive experience in PR and media relations;
- Proven track record of providing effective project implementation support to government entities for similar activities will be considered as an advantage.
- Working experience with EU and/or other Donors agencies.
- Fluency in both Albanian and English languages is required.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's *Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014)* ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

A Consultant will be selected in accordance with the Individual Consultants (IC) method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays.

The service will be selected under the provisions of the World Bank's Guidelines for the Selection and Employment of Consultants, dated January 2011, revised July 2014, based on the method of Selection of Individual Consultants (IC), Time Based Contract.

The complete Terms of Reference is posted on the website of CFCU: <http://cfcu.financa.gov.al>

Expressions of interest (CV, Cover letter and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail within June 16th, 2017.

Mano Simo, General Director
Central Finance and Contracting Unit (CFCU)
Ministry of Finance
Blvd: Dëshmorët e Kombit, No. 3, Tirana, Albania
Tel: +355 4 24 51 180
E-mail: mano.simo@financa.gov.al

E quajti LSI shpk, Gjoshë-Bashës: Tentove biznes me kanaçet

Ministrja e integritetit tregon për punën me Bashën në Bashkinë e Tiranës


Ministrja e Integritetit, Klajda Gjoshë, ka reaguar ndaj deklaratave të kryetarit të PD-së, Basha, se LSI është një shpk e Ilir Metës. E ftuar në emisionin "5 pyetje nga Babaramo" në "REPORT Tv", Gjoshë u shpreh se Basha nuk mund të flasë për sh.p.k sepse kur kishte drejtimin e Bashkisë së Tiranës, kërkoi të kthente në biznes edhe mbledhjen e kanaçeve të Coca Cola-s. "Është për të ardhur keq që fushtatë ektorale janë kthyer në fushata batutash. Është për të ardhur keq dhe mënyra e batutës që përdoret. Unë nuk kam bërë asnjëherë fushatë agresive për të kaluar në fyerje partiake apo personale, por më mirë të them se kur kam punuar në Bashkinë e Tiranës kur udhëhoqej nga Basha, e vetmja pikëpyetje që vija në lidhje me shpk-të ishte se edhe mbledhja e kanaçeve të Coca



Cola-s po kërkohet të kthehet në një biznes, kështu Basha nuk mund të flasë për sh.p.k", u shpreh Gjoshë. Ndërkohë, e pyetur për objektivat e LSI, Gjoshë u shpreh se LSI nuk është më një parti e vogël por një

parti që konkurren fare mirë me dy partitë që dikur konsideroheshin si partitë e vetme të mëdha. "Ne i kemi të gjitha mundësitë për të qenë forcë e parë, sepse me ne Shqipëria do të ketë drejtimin e duhur, fokusim në

shoqërinë shqiptare, do të fokusohemi te punësimi i të rinjve. Programi i LSI është shumë real. Është një program me këmbë në tokë. Përveç të rinjve kemi një program të fokusuar tek gratë, për ata sidomos që nuk kanë edhe bashkëshortin, për të marrë ndihmën e plotë ekonomike si edhe për të qenë pjesë e biznesit. Gratë duhet të përfaqësohen në biznes në 45 % dhe kjo do arrihet në katër vitet e ardhshme", -tha Gjoshë. Ndërsa për sa i përket ndonjë koalicioni të mundshëm me partinë socialiste, ministria tha se nuk ka pasur një ftesë zyrtare për vazhdimësi të koalicionit. "Të kërkojë një marrëveshje në media është diçka tjetër dhe të kërkojë një marrëveshje zyrtare është një tjetër. Ne nuk kemi bërë asnjë lloj parashikimi, më vonë pas zgjedhjeve do diskutohen këto çështje tani jemi të fokusuar te fushata", -u shpreh ministria.



MINISTRJA

"Ne i kemi të gjitha mundësitë për të qenë forcë e parë, sepse me ne Shqipëria do të ketë drejtimin e duhur"

Raporti, Vëzhguesit Vendor gati rekomandimet për klasën politike

Përgatitja për zgjedhjet / KVV ka publikuar raportin paraprak me mangësitë

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë ka publikuar raportin paraprak në lidhje me zgjedhjet e 25 qershorit, ku ka evituar mangësi të shumta por edhe ka dhënë rekomandime për klasën politike dhe institucionet përgjegjëse për administrimin e procesit zgjedhor. Raporti nis me një përmbledhje, ku janë evidentuar mungesa e transparencës së partive politike duke nisur që nga firmosja e marrëveshjes mes PS dhe PD-së çka solli edhe zgjidhjen e ngërçit politik, pavlefshmërinë e amendimeve të kodit penal për masat e reja të ndëshkimeve të shit-blejjes e votave apo dhe përfshirjen e administratës shtetërore në fushatë zgjedhore. Raporti përfshinë periudhën 1 prill deri më 3 qershor.

EVIDENTIMET

Dakortësia e Marrëveshjes Politike të 18 Majit, ndonëse shërbeu si një moment mad-

hor dialogu politik, i cili tejkaloi ngërçin institucional dhe siguroi pjesëmarrjen zgjedhore të forcave opozitare si kusht për legjitimitetin e procesit, thelloi akoma më shumë traditën jo shtetformuese të një vendimarrje jo-gjithëpërfshirëse dhe jo-transparente për proceset themelore që po kalon vendi. Rivendosja e afateve për regjistrimin e partive politike opozitare si subjekte zgjedhore, e pashoqëruar me amendim të kuadrit ligjor, u bë shkak për një vendimarrje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pa bazë ligjore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i gjendur nën trysinë e dinamikave politike dhe në volumin e zhvillimit të procedurave në ekstremitetet kohore, ka shfaqur një sjellje pozitive në komunikimin me vëzhguesit dhe në bërjen e transparencës. Sjellje kjo që nevojitet të përparojë gjithnjë e më shumë duke siguruar jo vetëm një administrim

ADMINISTRATA

Urdhëri i Kryeministrit shenjuan një precedent pozitiv në adresimin e shqetësimit të përfshirjes së administratës publike në mënyrë të paligjshme në fushatën zgjedhore

korrekt të procesit, por edhe duke reflektuar besimin për një proces të tillë.

Amendimet e "Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë" për rritjen e penalteteve të veprave që çenojnë integritetin e votimit dhe lirinë e zgjedhësve gjykohen si jo efektive. Këto amendime do të duhej të përcaktonin instrumenta ligjorë realë dhe efektive në denoncimin e rasteve.

Veprimtaritë në funksion të fushatës zgjedhore, jashtë periudhës zgjedhore ligjore, nga të gjitha partitë politike,

përpos shkeljeve të tjera, ishin edhe në shmangie të rregullimeve dhe transparencës që përcakton "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" për veprimtarinë financiare të subjekteve zgjedhore.

Amendimet e kryera në Ligjin "Për partitë politike" përsa i mbivendosen "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", në analizë të hierarkisë të së drejtës janë të pavlefshme.

Urdhëri i Kryeministrit të Republikës dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave shenjuan një precedent pozitiv në

adresimin e shqetësimit të përfshirjes së administratës publike në mënyrë të paligjshme në fushatën zgjedhore.

Angazhimi i disa institucioneve jo të thirrur shprehimisht nga kuadri ligjor zgjedhor si përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, shenjuan një precedent pozitiv, që duhet përvijuar më tej në rritjen e frymës së ndërveprimit institucional.

Transparenca dhe zbatueshmëria rigoroze e kuadrit ligjor prej institucioneve përgjegjëse në mbarëvajt-



| Nr. | Problematica e vërejtur sipas datave | 16/05/2017 | 27/05/2017 |
|--|--|------------|------------|
| A. Funkcionaliteti | | | |
| 1. | Numri i telefonave që rezultojnë jashtë shërbimit | 18 | 16 |
| 2. | Numri i telefonave që nuk i përgjigjen thirrjes | 17 | 34 |
| 3. | Numri i Sekretareve që pranojnë të komunikojnë | 52 | 50 |
| B. Probleme të infrastrukturës në KZAZ-të e kontaktuara | | | |
| 1. | Numri i KZAZ-ve të papajisura me kompjuter | 20 | 10 |
| 2. | Numri i KZAZ-ve të papajisura me shërbim interneti | 39 | 15 |
| 3. | Numri i KZAZ-ve të papajisura me skaner \printer | 31 | 16 |

jen e proceseve zgjedhore mbetet një problematikë madhore.

Rotacioni i ndodhur në përbërjen dhe drejtimin e trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zhbëri përfundimisht përpjekjet për një institucion kolegial dhe të pavarur. Ky zhvillim e bëri akoma më emergjente ndërhyrjen e thelluar dhe integrale në legjislacionin zgjedhor.

Precedenti i tejkalimit të afateve procedurale me vullnet politik, kërkon masa drastike në ripërcaktimin e afateve ligjore në legjislacionin zgjedhor për të zhbërë traditën e deri sotme.

Një problem që shihet më shqetësues nga KVV është pikërisht edhe mungesa e bazës materiale në KZAZ-të, të cilat në të shuktën e rasteve nuk janë pajisur ende me pajisjet me elementare siç janë telefonat dhe kompjuterat.

Tabela e paraqitur më poshtë pasqyron të dhëna të mbledhura nga komunikimi telefonik sipas kontakteve të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këto të dhëna referojnë përsa është përcjellë mangësitë infrastrukturore në periudhën e përcaktuar dhe evidentojnë funksionalitetin e komisioneve zgjedhore në nivelin e dytë.

■ DRITAN YLLI

“LSI-ja ka një shans për gruan, ka një shans për punësimin. Ju ftoj që edhe në 25 qershor të gjithë së bashku të dalim forcë e parë politike duke votuar numrin 1”.

AGRON ÇELA

“Ju garantoj të gjithëve, në emrin e gjithë shkoderëve se në Shkodër do të dalim forcë e para. Do të dalim forcë e parë, unë votoj 1 edhe 1 është shpresa, është garancia. Të gjithë ne do të bëjmë ndryshimin në Shqipëri.”



Luan Rama

Lëvizja Socialiste për Integrim organizoi një takim me banorët e Pukës, ku u prezantuan kandidatët për deputetë të qarkut Shkodër. Të pranishëm në këtë ishin Nënkrjetari i LSI-së, Luan Rama, Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, kandidatët për deputetë, Agron Çela, Dritan Ylli, Sajmira Laçi, etj. Në fjalën e mbajtur në këtë takim, Nënkrjetari i LSI-së, Luan Rama, njëkohësisht kandidat për deputet i LSI-së në qarkun e Tiranës, tha më 25 qershor duhet votuar numri 1 në fletën e votimit që është LSI. Sipas Ramës, fitorja e LSI-së është një shans për të gjithë, sepse Lëvizja Socialiste për Integrim është forca politike e rinisë. “Ne vijmë që të marrim besën tuaj për shërbim të pushtetit ndaj qytetarëve, për një qeverisje me drejtim të ri që qytetarin e ka të parin dhe interesin e tij mbi çdo interes tjetër. Prandaj në 25 qershor duhet votuar numri 1 në fletën e votimit që është LSI. Fitorja e Lëvizjes Socialiste për Integrim është fitore, është shans për të gjithë. Edhe për socialistët, edhe për demokratët, edhe për ata pa parti, sepse Lëvizja Socialiste për Integrim është forca politike e rinisë, është themeli i bazamentit të institucioneve

Luan Rama në Pukë: Pushteti në shërbim të qytetarëve

“Për një qeverisje me drejtim të ri që qytetarin e ka të parin dhe interesin e tij mbi çdo interes”

demokratike në Shqipërisë, është vetë stabilitetit dhe e ardhmja evropiane Shqipërisë”, - u shpreh Luan Rama, duke shtuar se përveç solidaritetit dhe humanizmit që ka LSI, kjo forcë politike është pranë njerëzve në nevojë në çdo moment. “LSI është forcë që ka në themelin vet solidaritetin. Njerëzit e këtyre anëve ia kanë dalë të fitojnë mbi vështirësitë pikërisht në saj të

solidaritetit me njëri tjetrin. Është ky solidaritet që ju bën juve të veçantë, prandaj LSI në Pukë është forcë e parë dhe do të jetë forcë e parë. Përveç besës dhe solidaritetit kemi edhe humanizmin sepse ne jemi pranë njerëzve në nevojë në çdo ditë të vitit”, - deklaroi Nënkrjetari i LSI-së, Luan Rama. Ndërsa, Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, theksoi në fjalën e tij se të rinjtë

janë shansi për ta ndryshuar politikën dhe se ata duhen të kenë besim tek e ardhmja e tyre në Shqipëri. “LSI forcë e parë do të thotë drejtim i ri për Shqipërinë. Fuqia e LSI-së është te rinia dhe te fjalë e dhënë e fjalë e mbajtur. Duam që të rinjtë ta ndiejnë që ky është vendi i tyre, ata janë shansi për ta ndryshuar këtë politikë, që të gjithë të rinjtë ta kenë besimin tek

e ardhmja e këtij vendi, të investohen për realizimin e një ndryshimi të madh, ta ndiejnë që kanë një shans për t'u arsimuar, për t'u punësuar këtu dhe për të krijuar familjet e tyre”, - tha Meta. Në këtë takim mbajti edhe një fjalë përshëndetëse kryesuesi i listës së kandidatëve për deputetë të LSI-së në qarkun Shkodër, Agron Çela, i cili u zotua se LSI-ja do të dalë

forcë e parë dhe se do të bëjë ndryshimin në Shqipëri. Kandidati tjetër për deputet i LSI-së në qarkun e Shkodrës, Dritan Ylli në fjalën e tij theksoi se LSI-ja është një shans për të gjithë pasi garanton hapjen e vendeve të reja të punës të mirëpaguara, uljen e taksave dhe zhvillimin ekonomik të vendi ndaj ajo do të dalë forcë e parë në zgjedhjet e 25 qershorit.

PDIU/ “NUK MUNDET DOT QE DY APO TRE VETE TE VENDOSIN FATIN E SHQIPTAREVE”

Idrizi: Ejani ta ndryshojmë bashkë skenën politike shqiptare

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet ka zhvilluar një takim elektoral në qytetin e Fierit për zgjedhjet e 25 qershorit. Në këtë takim ishte i pranishëm kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, kryesuesi i listës për deputet Nustret Avdullai, si dhe kandidatët e tjerë për deputet në qarkun e Fierit. Idrizi i kërkoi qytetarëve të Fierit që të votojnë PDIU-në dhe të zgjedhin për ti udhëhequr qytetarët e tyre, në mënyrë që të ndryshojnë skenën politike. “Ejani të bëhemi bashkë ta ndryshojmë skenën politike shqiptare. Të vëmë minimalisht politikanë normal e qytetarë normal që

të na udhëheqin. Qytetarë të Fierit, ju ftoj të votoni djemtë dhe vajzat tona, që në radhë të parë do të jenë qytetarë të Fierit e pastaj mbrojtës të kauzave të PDIU-së. Ne jemi këtu e rritemi përditë, sepse kauza jonë është kauza e çdo shqiptari, sepse kauza e shqiptarëve të Çamërisë që plotëson hartën identitare të kombit shqiptar është një frymëzim, një arsye e përbashkët, për t'i pasur të gjithë shqiptarët bashkë nga Preveza deri në Mollën e Kuqe. Të ngrihen në këmbë të gjithë djemtë dhe vajzat e Çamërisë dhe gjithë ata qytetarë të Fierit e të Shqipërisë

që mendojnë si ne, që ne kemi “Veç një Atdhe”. Ai që kryeson listën tonë, është jo vetëm një shqiptar patriot por në radhë të parë është një qytetar i shkëlqyer i Fierit. Sot PDIU-së i janë bashkuar të gjithë shqiptarët patriotë nga Tropoja në Konispol, nga Dibra, Kukësi, Shkodra, Korça, Fieri, Vlora, Tirana dhe kudo ku jeton e ka frymë shqiptari që mendon si ne, që kemi “Veç një Atdhe”, - u shpreh Shpëtim Idrizi. Kryetari i PDIU-së tha se do të kërkojë nga Parlamenti i ardhshëm që të ndryshojë ligjin për referendum, pasi shqiptarët kanë të drejtë të vendosin për fatin e tyre

dhe jo vetëm 2-3 parti. “Ju e dini miqtë e mi, që korifejtë e humanizmit, ata që sollën demokracinë, luftuan kundër pushtetit absolut të mbretit dhe bënë ndarjen e pushtetit në shumë duar. Kjo është demokracia, që të kemi shumë më tepër njerëz në vendimarrje. Kjo është arsyeja që ne do të propozojmë në Parlamentin e Shqipërisë ndryshimin e ligjit për referendum. Nuk mundet dot që dy apo tre vetë të vendosin për fatin e shqiptarëve, por në radhë të parë duhet të jenë qytetarët ata që duhet të vendosin. I keni parë ata që na kanë udhëhequr për 27 vjet?



Shpëtim Idrizi në Fier

Vijnë këtu para jush duke e stigmatizuar njëri-tjetrin, duke e mbajtur këtë vend të vogël e të begatë në një konflikt të vazhdueshëm, duke na mbajtur të ndarë në të majtë e në të djathtë, në besim fetar,

për një arsye të vetme, sepse nuk mund të vijnë dot para jush dhe të japin llogari për programin që kanë pasur para katër vjetëve, kur kanë marrë votën tuaj”, - u shpreh Shpëtim Idrizi.

Kavajë

Meta vlerëson kandidatin e LSI: CV-ja e tij për t'u pasur zili

Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, vlerëson kandidatin e LSI-së për Bashkinë Kavajë, Maksim Kona, i cili garon në zgjedhjet e pjeseshme lokale të 25 qershorit. Meta u shpreh se Kona është një personalitet me eksperiencë të shkëlqyer të cilin do ta kishin zili edhe në Bashkimin Evropian. “Maksim Kona është një figurë e shkëlqyer e Shoqërisë Civile dhe personalitet me një eksperiencë. Me CV-në që ka Kona do ta kishte zili edhe një qytet i zhvilluar i Bashkimit Evropian. I bindur se me dijet, aftësitë dhe qytetarinë e tij, Maksim Kona do t'i japë drejtim të ri Bashkisë së Kavajës. Kona do të hapë një faqe të re për këtë bashki dhe për qytetarët e Kavajës”, - u shpreh Meta. Për Kavajën garojnë edhe dy emrat të tjerë, vec Konës së LSI-së, Dorian Murati për PS-në dhe Isa Sakja për PD-në. Zgjedhjet në Kavajë ishin dekretuar për t'u zhvilluar në datë 7 Maj, por kryeministri Rama tërhoqi kandidatin dy ditë para garës, pasi opozita paralajmëroi për mosbindje civile dhe protesta. Tashmë pas marrëveshjes së 18 majit mes palëve, zgjedhjet në Kavajë do të zhvillohen në datë 25 qershor, pra në të njëjtën ditë me zgjedhjet parlamentare. Zgjedhjet e parakohshme në bashkinë e Kavajës zhvillohen pasi largimit të Elvis Rroshit, i cili u prek nga ligji i dekriminalizimit.

Fëmijët

Kur i kishin pyetur në shtëpi, fëmijët thanë që u zunë me njëri-tjetrin por dhe që edukatorja i rrahu. Kur prindërit pyetën në kopësht, edukatorja tha se fëmijët janë zënë me njëri-tjetrin duke mohuar të ketë vënë dorë mbi ta.

Dhunoit dy fëmijë pranga edukatores së kopshtit privat

Denida Rexhepi, u ndalua pasi u zbulua nga dy prindër kur panë pamjet filmike



Godina e kopshtit "4 stinët"

Edukatorja e një kopshti privat të kryeqytetit është arrestuar pasi ka ushtruar dhunë fizike ndaj fëmijëve. Denida Rexhepi, 30 vjeç edukatore në kopshtin "4 stinët" në rrugën "Nikolla Lena" është arrestuar të dielën pas denoncimit të dy prindërve, ndërsa pamjet e kamerave të sigurisë së kopshtit vërtetuan dhunën ndaj fëmijëve. Dy nënat e fëmijëve kanë parë shenja dhune në trupin e fëmijëve të tyre ndaj dhe kanë bërë kallëzimin në Komisaratin nr.2. Policia ka sekuestruar pamjet filmike të kamerave të sigurisë të kopshtit dhe po bën hetimet për të zbardhur më tej ngjarjen. Nga pamjet filmike u vërtetua sa edukatorja kishte rrahur dy fëmijë të mitur të kopshtit. Deneda Rexhepi u zbulua nga vetë prindërit që kishin vënë re shqetësime tek fëmijët e tyre. Kur kontrollloi kamerat e sigurisë, një prej prindërve zbuloi dhunën ndaj fëmijës së saj dhe bëri denoncimin në polici.

SHERRIN E FEMIJEVE E ZGJIDHI ME DHUNË

Ka qenë një sherr mes dy fëmijëve.



Denida Rexhepi, edukatorja e arrestuar

ijësh të vegjël në kopësht të cilin edukatorja Rexhepi e zgjidh me dhunë. Në një rast të ngjashëm kur dy fëmijë zihen dhe edukatorja duhet t'i bindë fëmijët që shërri fizik është i gabuar, Denida Rexhepi e zgjidh ndryshe, duke i rrahur fëmijët. Një prind i një fëmije zbulon për Shqiptarja.com sesi e zbuluan ngjarjen e dhunës në Kopësht. "Dy fëmijë, konkretisht dy vajza të vogla u zunë dhe edukatorja shkoi u jep nga një pëllëmbë në krah me fuqi. Por dhe ditën tjetër dy fëmijët u zunë dhe edukatorja nga dy pëllëmbë i bën 4 e 5 duke i shtrënguar me fuqi në krah. Në trupin e fëmijëve mbetën shenja. Kur i kishin pyetur në shtëpi, fëmijët thanë që u zunë me njëri-tjetrin por dhe që edukatorja i rrahu. Kur prindërit pyetën në kopësht mbi ngjarjen, edukatorja tha se fëmijët janë zënë me njëri-tjetrin duke mohuar të ketë vënë dorë mbi ta. Por prindërit të alarmuar kërkuan hapjen e kamerave dhe bënë denoncimin në polici dhe kur u panë pamjet filmike u zbulua e vërteta"-rrëfen një prind i një fëmije.Shqiptarja.



ANJEZA SHABANI
Ky nuk është rasti i vetëm i dhunës në kopshtet private. Një vit më parë administratorja e ish-kopshtit privat "Diren" Anjeza Shabani dhunoi në mënyrë barbare një fëmijë. Edhe në rastin e kopshtit "4 Stinët" ka ndodhur i njëjti fenomen, ku janë dhunur dy fëmijë.


com mëson se viktimë e dhunës së edukatore Denidës nuk kanë qenë vetëm 2 fëmijët, por bëhet fjalë dhe për një vajzë të tretë. Ndërkohë ky nuk është rasti i vetëm i dhunës në kopështin "4 Stinët". Një nënë tha se vajza e saj 4-vjeç është dhunuar në muajin janar nga një tjetër edukatore në të njëjtin kopësht. "Më tha vajza që nuk pikturoj më sepse dje pikturova keq dhe më rrahu edukatorja. Kërkova kamerat, por më thanë që nuk ishte rrahur, por nuk bëra denoncim në Polici", - tha nëna e një tjetër fëmije. Mbeten hetimet e policisë për të zbuluar të vërtetën.

KEQTRAJTIMI I TË MITURVE

Denida Rexhepi do akuzohet për veprën penale "Keqtrajtimi i të miturve". Kjo veprë dënohet sipas kodit penal me gjobë deri në 2 vite burg. Policia ka marrë në pyetje pronaren e këtij kopshti privat dhe edukatorët e tjera, të cilat kanë thënë se nuk kishin dijeni për dhunën. Sipas edukatoreve ky është rasti i vetëm i dhunës që ka ndodhur në kopshtin "4 stinët".

ZHDUKJA/ POLICIA E TIRANËS ARRESTON NËNËN ADOPTUESE

Gjenden dy fëmijët amerikanë në polici denoncojnë nënën për dhunë



Pas 5 ditë të zhdukur, pasditën e djeshme janë arritur të gjenden dy vëllezërit Amerikanë. Ata rezultuan të zhdukur që prej datës 30 maj 2017. Lokalizimi i tyre është bërë në zonën e quajtur "Kodrat e Selitës", ndërkohë që pas kësaj situate dhe shoqërimit të tyre në polici, ata kanë deklaruar se janë larguar nga shtëpia pasi i keqtrajtonte nëna e tyre, që i kishte adoptuar. Nisur nga kjo situatë, policia ka marrë në pyetje dhe nënën e dy vëllezërve të adoptuar, e cila ka mohuar akuzën. Ndërkohë nga marrja në pyetje në prezencë të psikologes, fëmijët kanë deklaruar se janë larguar nga banesa si pasojë e dhunës që nëna ushtronte ndaj tyre. Në bazë të kallzimit të marrë nga fëmijët dhe konsultimit me

prokurorin, u bë arrestimi në flagrancë i kësaj shtetaseje. Gjithashtu gjatë ekzaminimit fizik të dy fëmijëve, është konstatuar se ata ishin me shenja dhune në trup. Në bazë të kallzimit të marrë nga fëmijët dhe konsultimit me Prokurorin, u bë arrestimi në flagrancë i shtetases Andrea Grace Bailey-Kay. Dy vëllezërit e mitur rezidentë në Tiranë, Tavish Taog Bailey-Kay, 14 vjeç dhe Tadh Magnus Bailey-Kay, 17 vjeç ishin parë herë të fundit në zonën e Laprakës në Tiranë. Më i vogli prej djemve, 14-vjeçari vuan nga probleme mendore ndërsa gjetja e tyre u vështirësua edhe nga fakti që djemtë nuk dinin shqip. Dy amerikanët janë zhdukur dhe njëherë në vitin 2015 në Somona të Meksikës.

NGJARJA

Në kërkim 35-vjeçari, goditi me thikë transgjitorin Anxhela



Transgjitorin Fatjon Hoxha njohur ndryshe si Anxhela është goditur me thikë një ditë më parë në Tiranë. Ngjarja sipas policisë ka ndodhur pranë parlamentit në rrugën "Xhorxh Bush" dhe autori një 35-vjeçar dyshohet se e ka goditur Anxhelën 2 herë me thikë. Transgjitorin ka marrë mjekimin pranë qendrës spitalore "Nënë Tereza" dhe pasi ka lënë ambientet e spitalit ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Për këtë ngjarje kanë nisur hetimet nga komisarati numër 1. Po kështu ka nisur hetimet për gjetjen e autorit të kësaj ngjarje.

Vendimi, Gjykata: Ja pse rrëzuam pretencën e Selmanit

Zbardhen argumentat për dënimin e Llanaj e dy të tjerëve në masakrën e "Çoles"

ELTON QYNO
TIRANE

Gjykata e Lartë zbardh argumentat e rrëzimit të pretendencës së prokurorit Artur Selmani, i cili kërkoi nga kolegji penal, ndryshimin e akuzës së vrasjes për Aleksandër Llanaj dhe dënimin e tij me 4 vjet burg, për akuzën e vrasjes për vetëmbrojtje. Në vendimin e saj, gjykata ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe shkallës së parë Vlorë, që dënonte me 35 vite burgim Aleksandër Llanaj, 35 vite burgim Bertil Alliaj dhe 35 vite burg Ani Begaj. Sipas Selmanit akuzat për vrasje me dashje, në dëm të shtetasve Haki Rakipi dhe Ardi Velaj duhet të pushoheshin, duke lënë në fuqi vetëm fajësinë dhe dënimet përkatëse të tyre për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Kjo pretendencë është pritur me shumë optimizëm nga familjarët e të pandehurve, ndërsa të afërmit e viktimave i ka shkruar presidentit Nishani, se pas pretendencës që kishte kërkuar prokurori, djemtë e tyre ndiheshin të vvarë për herë të dytë. Pasi nëse Gjykata e Lartë do të pranonte këtë pretendencë, atëherë shumë shpejt njëri nga autorët, pasi dy janë në kërkim, do të lirohej menjëherë nga burgju. Letra është administruar nga Presidenti dhe më pas, me përmbajtjes e saj është njohur dhe Prokurori i Përgjithshëm Adriatik Llalla. Për shkak të pretendencës, Llalla urdhëroi pezullimin e prokurorit Artur Selmani dhe Alma Muçës.

ARGUMENTIMI I GJYKATËS

Kolegji penal vlerësoi se, këto përfundime të gjykatave të faktit janë rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor, pas administrimit, shqyrtimit dhe analizës së provave në bazë të ligjit procedural dhe vlerësimit të tyre. Ndryshe, nga çfarë parashtrohet në rekursin e paraqitur nga të pandehurit, gjykata e apelit Vlorë, me të drejtë ka vlerësuar të bazuar në ligj vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi nga analiza e akteve të dosjes i ka rezultuar e provuar se, i pandehuri Aleksandër Llanaj ka kryer vrasjen me dashje me armë luftarake të shtetasve Haki Rakipi (Akil Hasanaj) dhe Ardi (Feridian) Velaj duke i shkakuar atyre vdekjen. Këto veprime, janë kryer nga i pandehuri Aleksandër Llanaj në bashkëpunim me të pandehurin Ani Begaj dhe të pandehurin Bertil Alliaj, si dhe të ndjerin Albi Limaj (i cili kishte organizuar takimin me shtetasit Haki Rakipi dhe Ardi Velaj). Po kështu nga provat e administruara në gjykim, ka rezultuar se para kryerjes së takimit, shtetasi Albi Limaj

AUTORËT



Aleksandër Llanaj



Ani Begaj



Bertil Alliaj

dhe i pandehuri Aleksandër Llanaj janë pajisur me mjete të nevojshme për kryerjen e veprës penale dhe se mbërritja e tyre në lokal "Ador"

është bërë nga i pandehuri Ani Begaj nëpërmjet drejtimit të mjetit me targa AA 323 AO. Ka rezultuar njëkohësisht se futja e të pandehurit Aleksandër Llanaj në automjet është bërë nga i pandehuri Ani Begaj, i cili ka komunikuar me të pandehurin Bertil Alliaj duke mundësuar kështu largimin nga vendi i ngjarjes i armëve të zjarrit me të cilin ishin realizuar goditjet i pandehuri Aleksandër Llanaj dhe shtetasi Albi Limaj. Ndërkohë ndryshe, nga sa parashtrohet prokuroria pranë gjykatës së apelit në rekursin e saj, në lidhje me vdekjen e të ndjerit Albi Limaj, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, me të drejtë kanë vlerësuar se, ka rezultuar e provuar te çdo dyshimi të arsyeshëm se, ajo nuk ka ardhur si rezultat i veprimeve të kundërligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme të pandehurit Aleksandër Llanaj.

PLUMBI NË BLUZË

Ka rezultuar e provuar se, i ndjeri Albi Limaj, ka hyrë në të njëjtën kohë me të pandehurin Aleksandër Llanaj në verandën e lokalit "Ador" dhe ka dalë prej andej i plagosur, si rezultat i shkëmbimit të zjarrit midis të pandehurit Aleksandër Llanaj dhe shtetasit Haki Rakipi. Nga administrimi i aktit të


VIKTIMAT



Hasan Rakipi



Albi Limaj



Ardi Velaj

ekspertimit mjeko-ligjor, ka rezultuar e provuar se, shkak i vdekjes së të ndjerit Albi Limaj ka qenë shoku traumatiko-hemorragjik, viktimia ka



Artur Selmani

patur dëmtime në kokë, një plagë në brinjë, një plagë mbi kockën e legenit, ndërkohë nga heqja e rrobave është gjetur një predhe arme zjarri, kalibër 9 mm, nga ekzaminimi i së cilës, ka rezultuar se, ajo ka qenë e kalibrit 9 mm x 17 mm, që përdoret nga pistoletat kalibër 9mm x 17 mm. Në tërësinë e tyre, pretendimet e paraqitura në rekurs, kanë të bëjnë me analizën e provave të bëra nga gjykatat e faktit. Marrja dhe vlerësimi i provave është atribut i gjykatave të faktit, pra i gjykatës së shkallës së parë dhe i asaj të apelit. Gjykata e Lartë nuk shqyrton faktet dhe rrethanat e çështjes, por vetëm zbatimin dhe interpretimin e ligjit në dy shkallët e gjykimin.

DHUNA

Sharje e grushta infermierit në QSUT, arrestohet 45-vjeçari



Një 45-vjeçar është arrestuar ditën e djeshme pasi ka ushtruar dhunë ndaj infermierit. Bujar Çokaj ka ofenduar dhe goditur me grusht infermierin R.K. 25 vjeç, banues në Tiranë. Ngjarja ka ndodhur në Urgjencën e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", në kryeqytet. Më datë 4 qershor 2017, u arrestua shtetasi Bujar Çokaj, 45 vjeç, banues në Tiranë, sepse në Urgjencën e Q.S.U.T, për shkak të detyrës, ka sharë, ofenduar dhe goditur me grusht, infermierin R.K., 25 vjeç, banues në Tiranë.

VRASJA E SHQIPTARIT

Detaje të ekzekutimit të Ilir Hidrit nga Vora në Ekuador

Zbardhen detaje nga ekzekutimi i 40-vjeçarit Ilir Hidri në Ekuador me datë 1 qershor. Shqiptari nga Vora i vvarë 4 ditë më parë me 3 plumba pas koke në Ekuador është ekzekutuar nga një tjetër shqiptar. Hidri i infiltruar i policisë në rrjetin e drogës. Sipas të dhënave paraprake Ilir Hidri dyshohet se është vvarë pasi prej disa kohësh ai ishte inf-



litruar në një rrjet të trafikut të kokainës nga Amerika Latine në Europë e Shqipëri. Sipas hetimeve paraprake rezultoi se 40-vjeçari kishte shkëmbyer informacion me policinë e disa vendeve për një sasi të madhe kokaine që do vinte në Europë. Hidri qëndronte në Ekuador prej 3 muajsh ndërsa më parë kishte qenë në Europë e Amerikë. Burimet

sqarojnë se Policia e Ekuadorit ka identifikuar autorin nga pamjet e kamerave të sigurisë. Hidri ishte me rezidencë në qytetin e Vorës ndërsa ka qenë i dënuar më parë për trafik droge nga Amerika Latine në Europë. Për zbardhjen e vrasjes së Hidrit janë angazhuar një serë agjencish ligjzbatuese. Trupi i Hidrit ende s'ka mbërritur në Shqipëri.

Dëshmon e fejuara e Çollakut: Rrëmbimin e mësova tek lokali

Zbardhet dëshmia e Amanda Thanos, e kamarierit dhe e menaxherit të lokalit ku ndodhi krimi

ELTON QYNO
TIRANE

Asnjë konflikt

Më tej kjo e fundit ka pohuar se ka pasur një lidhje 7 vjeçare me Gazment Çollakun dhe në asnjë rast, ai nuk i ka thënë rreth aktivitetit të tij, por edhe ndonjë problem që mund të ketë pasur. Thano në dëshminë e saj ka shtuar se e njihnte të pandehurin Denis Shtraza, pasi e ka pasur në lagjen e saj të banimit.

Katër dëshmitarët e parë të prokurorisë së Krimeve të Rënda, kanë dëshmuar në gjyqin kundër të pandehurit Denis Shtraza, i akuzuar për veprën penale të "Rrëmbimit, torturimit me pasojë vdekjen" e shtetasit Gazmend Çollaku. Ish-e fejuara e këtij të fundit, shtetësja Amanda Thano, ka qënë dëshmitarja e parë e këtij procesi gjyqësor, ku ka deklaruar para gjykatës momentet e fundit që ka qënë në

shoqërinë e ish-të fejuarit të saj, Gazmend Çollakut. Sipas Thanos, ajo s'ka pasur asnjë dijeni për konfliktet e Çollakut. "Kisha dijeni që shkonte herë pas here në Itali, herë për blerjen e makinave, pasi merrej me tregti makinash dhe

herë të tjera tek miqtë e tij"-ka pohuar vajza 27 vjeçare. Më tej kjo e fundit ka pohuar se ka pasur një lidhje 7 vjeçare me Çollakun dhe në asnjë rast, ai nuk i ka thënë rreth aktivitetit të tij, por edhe ndonjë problem që mund të ketë pasur. Thano

në dëshminë e saj ka shtuar se e njihnte të pandehurin Denis Shtraza, pasi e ka pasur në lagjen e saj të banimit.

DREKA NË GOLEM E VRASJA NË MBRËMJE

E veshur tërësisht me të

zeza, 27-vjeçaria Amanda Thano, ka treguar para trupit gjykues të gjithë intenerarin e ditës kur ka ndodhur krimi. Ajo pohoi se në 6 janar 2015, tre orë para se të vritej ish-i fejuari i saj, kanë qënë duke drekuar në një restorant në Golem. "Atë ditë kemi lëvizur me një automjet të bardh, tip "Mercedes Benz" që ishte blerë pak kohë nga Gazi. Ai më ka ardhur tek Hipoteka, ku unë punoj dhe kemi shkuar në Golem Kemi ngrënë drekë, dhe sërisht jemi larguar. Më ka lënë tek Hipoteka, dhe ai është larguar pasi e lamë të takoheshim në lokalit "Porsaidi" ku Gazi qëndronte zakonisht. Kam mbaruar punën dhe pas disa orë, jam larguar drejt lokalit. Kur kam shkuar aty, kam parë që para lokalit kishte shumë efektivë policie dhe aty jam njoftuar se ishte rrëmbyer Gazmendi"-ka treguar para gjykatës Amanda Thano. Kjo e fundit ka shtuar se nuk kishte asnjë dijeni për konfliktet e të fejuarit të saj.

KAMARIERI DHE MENAXHERI I LOKALIT

Në seancën e djeshme gjyqësore në pyetje është marrë dhe kamarieri dhe menaxheri i lokalit. Klodjan Kadriu dhe Taulant Lala, kanë pohuar para gjykatës momentet kur kanë kuptuar se diçka e pazakontë ndodhi në lokalit e tyre. Sipas dy dëshmitarëve, kanë arritur të shohin katër persona të veshur si policë, por nuk kanë mundur ti identifikonin ata. "Njëri nga menaxherët e lokalit Indrit Tafili ka marrë një mikun e tij në polici, duke i thënë se personat që kanë rrëmbyer Gazin, ishin policë, por ai i është përgjigjur se nuk ishte e vërtetë"-kanë thënë dëshmitarët. Ata kanë pohuar se Çollaku qëndronte zakonisht në atë kafene, pasi kishte njohje me pronarët e lokalit Ervis Doçi dhe Bledin Doçi.



ASNJË KONFLIKT

Më tej kjo e fundit ka pohuar se ka pasur një lidhje 7 vjeçare me Çollakun dhe në asnjë rast, ai nuk i ka thënë rreth aktivitetit të tij, por edhe ndonjë problem që mund të ketë pasur.

MASA E SIGURISE

Lihet në burg miku i Elton Çiçës u arrestua për trafik droge



Lihet në burg biznesmeni Renato Çausi, i cili akuzohet për trafik ndërkombëtar droge dhe është mik me Elton Çiçën, të vrarë në 1 maj të 2015-së. Tre ditë më parë policia ka arrestuar Renato Çausin, që njihet edhe me emrin Andrea Çausi. Ka qënë një hetim 2-vjeçar i Prokurorisë italiane me Prokurorisë e Krimeve të Rënda në Shqipëri, i cili ka zbuluar se Çausi drejtonte një rrjet ndërkombëtar për trafikun e narkotikëve. Renato Çausi është arrestuar në momentin që po lëvizte me një makinë të blinduar në Tiranë. Kanë qënë oficerë të RENEAS dhe FNSH që kanë vënë në pranga biznesmenin. Gjithashtu burime nga prokuroria thonë se Renato Çausi dyshohet si personi që drejtonte rrjetin e kanabisit në jug të vendit, sidomos në zonën e Tepelenës. Çausi ishte mik i ngushtë me Elton Çiçën dhe dyshohet se lidhjet e tyre të ngushta kanë qënë edhe për kanabisin. Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe Prokuroria italiane kanë dalë në përfundim se një sasi droge e kapur në vitin 2016 ishte e Renato Çausit.

Vendimi

TIRANE

Ilir Xhakja merr dënimin e dytë për telefonin në qeli

Khakja vuan dënimin me burgim të përjetshëm për vrasen e Tahirajt

Ilir Xhakja, i dënuari me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Krimeve të Rënda, është dënuar me 1 vit burg pasi në ambjentet e qelisë së tij, është gjetur një aparat telefonik. Vendimi është dhënë nga gjykata e Krujës, ku gjyqtarja Nazmie Pengili, e ka deklaruar fajtor të pandehurin Ilir Xhakja duke e dënuar me 1 vit burgim për akuzën "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në I.E.V.P. në burje". Në 10 tetor 2013 Gjykata e Krimeve të Rënda ka dënuar me burgim të përjetshëm Ilir Xhakjen, vrasësin e kryekomisarit të Shijakut, Adem Tahirajt. Kolegji Penal e ka cilësuar fajtor të pandehurin për akuzat e vrasjes në rrethana cilësuese, kundërshtimit të punonjësve të policisë dhe armëmbajtjes pa leje, ndërsa e ka shpallur të pafajshëm për akuzën e vrasjes me dashje, pasi nuk provohet që e ka kryer këtë veprë penale. Sipas vendimit, nga hetimi gjyqësor, rezultoi se më datë 13 shtator 2012, rreth orës 17:00, me urdhër të Tahirajt, forcat e Komisarariatit të Shijakut kanë dalë në patrullim. Automjetet kishin të shënuara në mënyrë të dukshme të gjitha mbishkrimet dhe shenjat e policisë. Ato ishin tre dhe lëviznin në njëshkolonë, njëri pas tjetrit. Fillimisht u patrullua në rrugën drejt Katundit të Ri. Më pas, u vazhdua me dy automjete dhe shefi i komisarariatit ka qënë i shoqëruar vetëm nga oficeri Kastriot Gosturani dhe polici Fatos Hoxha. Më pas, në vendngjarje afrohet një automjet Mercedes, tip Regina 320, i pajisur vetëm me një targë të



huaj në pjesën e pasme, i cili ndaloi përbri automjeteve të policisë. Prej tij zbriti një person, i identifikuar më pas si Ilir Xhakja, person me precedentë të shumtë kriminalë. Gjatë këtij gjykimi, u provua se ky person u drejtua tek automjeti tip Opel, hapi derën e pasagjerit dhe nxori përjashta me dhunë policin Fatos Hoxha, duke iu drejtuar me fjalët: "Ç'punë ke ti me nipin tim?". Polici u prezantua menjëherë dhe personi që sulmoi ndërpreu për një çast veprimet ndaj tij. "Unë

jam ai që të q... motrën" dhe nxori pistoletën nga brezi. U provua gjatë gjykimit se në këtë moment, shefi i komisarariatit, bëri prapa duke i bërë thirrje Ilir Xhakes që të mos afrohej, kurse polici Fatos Hoxha ndërhyri duke i dalë para autorit dhe duke bërë titur disa herë me zë të lartë: "Është shefi i Komisarariatit...!". I pandehuri Ilir Xhake, duke shtyrë me trup policin, mundi të vendosë dorën mbi supin e tij dhe qëlloi gjashtë herë rresht mbi trupin e kryekomisarit.

■ **NË FOTO:** I dënuari me burgim të përjetshëm Ilir Xhakja në sallën e gjyqit

Valutat


Sipas BSH, politika monetare stimuluuese e bankës do të transmetojë më mirë nëse do të kishte më shumë transaksione në monedhën vendase

**LIDHJET**

Sasia e madhe e remitancave dhe lidhjet tregtare e bankare me anëtarët e Eurozonës, Itali dhe Greqi, por edhe me fqinjët e Kosovës dhe Malit të Zi, kanë bërë që shqiptarët e përdorin gjerësisht euron

PËRMASAT

Një dekadë më parë, 80% e huadhënies ishte në valutë, por raporti ka ndryshuar në 55% në euro. Megjithatë, depozitat bankare në euro përbëjnë 60 për qind të totalit të kursimeve të klientëve shqiptarë

**Kreditimi**

Plani për të reduktuar kreditë të këqija bëri të mundur që ky tregues të ulet, nga 23.5% e totalit të kredisë në 2013-ën, në 16.6% në prill 2017

Banka qendrore e Shqipërisë dëshiron të frenojë përdorimin e euros, në mënyrë që politika e saj monetare të funksionojë më mirë dhe të mbrojë sistemin e saj bankar nga goditjet e kursit të këmbimit. Ka deklaruar kështu dje, në një intervistë për agjencinë e lajmeve REUTERS, guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko.

Sipas tij, nuk është fjala për një përpjekje për largimin e euros nga ekonomia e Shqipërisë, vend kandidat për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian. Por plani i bankës qendrore është për të nxitur gradualisht rritjen e përdorimit të lekut në financa dhe ekonomi. "Së pari, ne duam të rrisim fleksibilitetin dhe efikasitetin e politikës sonë monetare në monedhën vendase. Politika monetare stimuluuese do të transmetojë më mirë nëse do të kishte më shumë transaksione në monedhën vendase," tha Sejko. Banka, gjithashtu, dëshiron "të ruajë dhe mbrojë stabilitetin financiar, pasi një nivel i lartë i huadhënies në euro do të ekspozonte sistemin bankar shqiptar ndaj rreziqeve të kursit të këmbimit", shtoi ai.

"Ne synojmë të shtojmë përdorimin masiv dhe ekspozimin e monedhës vendase në një masë të krahasueshme me vendet me një ekonomi të ngjashme me tonën në një mënyrë graduale", tha Sejko.

PËRDORIMI

Sasia e madhe e remitancave nga emigrantët, si dhe lidhjet e fuqishme tregtare dhe bankare me anëtarët e Eurozonës, Itali dhe Greqi, por edhe me fqinjët e Kosovës dhe Malit të

BSH synon të bëjë lekun "violinë të parë" në treg

Intervistë e guvernatorit Sejko për REUTERS; ende 60% e kursimeve janë në euro



Zi, që përdorin monedhën e përbashkët, kanë bërë që shqiptarët e përdorin gjerësisht euron.

Një dekadë më parë, në sistemin bankar të vendit u arrit rekord pasi 80 për qind e huadhënies ishte në valutë, kryesisht euro dhe pjesa tjetër në lekë, por raporti që atëherë

ka ndryshuar në 55 për qind në euro dhe 45 për qind në lekë, e ndihmuar nga ulja e normës bazë në një nivel të ulët rekord prej 1.25 për qindësh. Kjo ngushtoi kostot relative të huamarrjes dhe huadhënies.

Megjithatë, depozitat bankare në euro përbëjnë 60 për qind të

kursimeve. Sejko tha për REUTERS-in se banka qendrore po inkurajonte bankat tregtare të mbajnë depozita në lekë dhe këto të fundit po këshillojnë edhe klientët e tyre që të konvertojnë kreditë në lekë. "Ne synojmë të rrisim masën e përdorimit dhe ekspozimit të

monedhës vendase në një shkallë të krahasueshme me vendet me një ekonomi të ngjashme me tonën, në mënyrë graduale," tha Sejko.

SEKTORI BANKAR

Një marrëveshje trevjeçare me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) prej 330 milionë eurosh ndihmoi në koordinimin më të mirë të politikës fiskale dhe monetare, solli rritje graduale të qëndrueshme dhe kontroll më të mirë të borxhit publik, tha Sejko. Ai tha se qeveria e re që do të formohet pas zgjedhjeve të 25 qershorit duhet të përqendrohet në reformat strukturore. Ndërkohë, guvernatori përshëndeti faktin se plani për të reduktuar kreditë të këqija kishte bërë të mundur që ky tregues të ulet, nga 23.5 për qind e totalit të kredisë në 2013-ën, në 16.6 për qind në prill 2017. "Kjo ka ardhur falë fshirjes së kredive të humbura prej tre vjetësh, ristrukturimit të tyre dhe performances së klientëve ekzistues", shtoi ai. "Kjo tregon se politika jonë është duke funksionuar".

POLITIKAT

Ndërkohë, sa u përket politikave monetare, Sejko tha se, pasi ka ulur normën bazë, nga 6.25 për qind në fund të vitit 2008, në 1.25 për qind aktualisht për të stimuluar investimet dhe konsumin, BSH do të ruajë një politikë stimuluuese deri në fund të vitit 2017. "Nëse kjo politikë monetare stimuluuese do të vazhdojë apo jo, do të varet nga treguesit makroekonomikë në të ardhmen", tha Sejko, duke përmendur sinjale të rritjes së rritjes në Eurozonë, të cilat ndikojnë Shqipërinë nëpërmjet tregtisë dhe investimeve.

STATISTIKAT / KRYESOJNË ÇMIMET E NAFTAËS DHE GAZIT ME +37.3%

INSTAT: Rriten ndjeshëm çmimet e prodhimit

Tremujori i parë, industria nxjerrëse +10.3 për qind

Në tremujorin e parë të vitit 2017, indeksi i çmimeve të prodhimit u rrit 5.1% në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2016 dhe 1.8% në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2016, njoftoi dje INSTAT.

Rritjen më të lartë në nivel vjetor e kanë shënuar çmimet e prodhimit në seksionin "industri nxjerrëse" me 24.3%. Brenda kësaj industrie, vihat re rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve në nxjerrjen e naftës bruto dhe gazit natyror me 37.3%. Referuar të njëjtës periudhë krahasimi, çmimet e prodhimit në aktivitetet e industrisë përpunuese kanë shënuar rritje me 2.6%. Brenda



kësaj industrie vihat re rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve në aktivitetin e

metalurgjisë me 13.6%, të produkteve të duhanit me 6.3% dhe prodhimi i pro-

dukteve kimike me 3.8%. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2016, çmimet e prodhimit të produkteve vendase shënuan rritje me 2.8%.

Çmimet e prodhimit të produkteve për eksport kanë shënuar rritje me 10.6% krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

TREMUJORI

Çmimet e prodhimit në seksionin "industri nxjerrëse" shënuan rritje me 10.3%, krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Rritjen më të lartë e shënuan çmimet e prodhimit në aktivitetin "nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror" me 15.3%.

Çmimet e prodhimit në seksionin "industria përpunuese" kanë shënuar rritje me 1.3%, krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Brenda kësaj industrie vihat re rritje e çmimeve të prodhimit të produkteve në aktivitetet: metalurgji me 3.5%, konfeksionimi i veshjeve me 0.6%, prodhimi i produkteve ushqimore me 0.3%.

Indeksi i çmimeve të prodhimit për produktet vendase ka shënuar një rritje me 2.3% krahasuar me tremujorin e katërt 2016. Vlen të përmendet rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve në seksionet; "industri nxjerrëse" me 4.7% dhe "industri përpunuese" me 0.8%.

Maturantët, skema e vlerësimit për provimin e gjuhës së huaj

Vëzhgim i rreptë. Nuk lejohen kopjet. Përgjigjet e testit brenda datës 20 qershor

Ministria e Arsimit ka publikuar përgjigjet e sakta për provimin e gjuhës së huaj. Gazeta sot publikon skemën e vlerësimit për dy varjantet e provimit të anglishtes. Janë rreth 40 mijë maturantë që u testuan ditën e djeshme në të gjithë vendin. Testi për provimin e gjuhës së huaj kishte 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen nga 1 pikë secila dhe 12 pyetje janë me zhvillim, që vlerësohen me 37 pikë. Testi do të vlerësohet me 50 pikë. Vlerësimi i përgjigjeve të maturantit bëhet me pikë, të cilat ekuivalen në notë të përkallëzuar. Përgjigjet e provimit të gjuhës së huaj pritet të dalin Brenda datës 20 qershor. Edhe këtë vit nuk ka ndryshuar formula e pranimit të kandidatëve në universitet, ku përparësi d të ketë mesatarja.

VËZHIM I RREPTË. Pas rreth 4 orësh të qëndruari në klasë 40 mijë maturantë në vend kanë përfunduar provimin e anglishtes. Provimi ka nisur në orën 08:30 dhe përfundoi rreth orës 12:30 të së hënës. Maturantët e gjimnazit "Ismail Qemali" kanë ndarë emocionet e para pas provimit. Ata shprehën se kanë qenë nën vëzhgim të rreptë ndërsa nuk besojnë se teza të ketë dalë para provimit

siç u aludua në media. "Nuk mendoj se mund të dalë teza. Nuk na lanë të komunikojmë, na kanë qëndruar te koka duke na vëzhguar. Në klasë ishte një person që kontrollonte ndërsa edhe ne korridor ka pasur njerëz të tjerë që vëzhgonin", tha një nxënës. Një maturant i duhen së paku 10 pikë për të qenë kalues. Pas katër ditësh, maturantët do t'i nënshtrihen provimit të dytë me detrim, gjuhës shqipe dhe letërsisë, ndërsa në datën 15 qershor zhvillohet provimi i Matematikës. Të fundit, dy provimet me zgjedhje ku do të futen maturantët të rinj e të vjetër, të përcaktuara në formularin A1/A1Z do të zhvillohen në datën 23 qershor.

PROVIMET ETJERA

Për sa i përket provimeve të tjera Ministria e Arsimit thotë se: Maturanti praqitet në qendrën e provimit, 1 orë e 30 minuta përpara fillimit të provimit. Në momentin e paraqitjes në mjediset e provimit, duhet të ketë dokumentin e identifikimit dhe mjetet e nevojshme si: laps, vizore, kompast, makinë të thjeshte llogaritëse. Kandidati plotëson testin me stilolaps me një ngjyre. Në pyetjet me alternative, maturanti rrethon vetëm shkronjën përbri përgjigjes së saktë. Nëse rrethon më shumë se një alternativë, ose nuk rrethon asnjë alternativë, vlerësohet me 0 pike.



TESTI

Testi për provimin e gjuhës së huaj kishte 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen nga 1 pikë secila dhe 12 pyetje janë me zhvillim, që vlerësohen me 37 pikë

FORMULA

Përgjigjet e provimit të gjuhës së huaj pritet të dalin Brenda datës 20 qershor. Edhe këtë vit nuk ka ndryshuar formula e pranimit të kandidatëve në universitet, ku përparësi d të ketë mesatarja.

| SKEMA E VLERËSIMIT | | |
|--|--|------------|
| GJUHË ANGLEZE (Niveli B1) | | Varianti A |
| READING SECTION | | |
| <i>For the open-ended questions, answers may be brief or may be written in full sentences. Accept either provided the information in the key is included! Do not take marks off for incorrect grammar or spelling in a longer answer. Do not accept answers which are too long and contain irrelevant information.</i> | | |
| Question | Answer | Points |
| 1 | A | 1 |
| 2 | a) From Dublin / From Ireland / Dublin b) It is not an easy job. / Not easy / Hard | 1 |
| 3 | a) In the city center b) Her boss | 1 |
| 4 | a) (Because) she has to smile at clients all time and pay attention to what they say. b) Dublin | 1 |
| 5 | a) She couldn't speak Greek / She didn't know a word of Greek b) A musical band / A famous band / A band / Her favourite band | 1 |
| 6 | D | 1 |
| 7 | A | 1 |
| 8 | a) Advertisement 1 / The first advertisement / 1 b) Advertisement 2 / The second advertisement / 2 | 1 |
| 9 | a) Advertisement 1 / The 1st advertisement / 1 b) He / She will correct tests | 1 |
| 10 | a) Advertisement 2 / The 2nd advertisement / 2 b) Advertisement 3 / The 3rd advertisement / 3 | 1 |
| 11 | a) Advertisement 3 / The 3rd advertisement / 3 b) Advertisement 1 / The 1st advertisement / 1 | 1 |
| 12 | C | 1 |

| Skema e vlerësimit | | |
|----------------------------|-------------------------------------|------------|
| Gjuhë anglishe (Niveli B1) | | Varianti A |
| USE OF LANGUAGE SECTION | | |
| 13 | B | 1 |
| 14 | C | 1 |
| 15 | C | 1 |
| 16 | A | 1 |
| 17 | B | 1 |
| 18 | C | 1 |
| 19 | D | 1 |
| 20 | B | 1 |
| 21 | C | 1 |
| 22 | a) doing b) Why c) on | 3 |
| 23 | a) nice b) suit c) exactly d) cheap | 4 |
| 24 | a) For b) respect c) so d) before | 4 |

B1 Level Examination Writing Section

The writing section is scored out of a total of ten points. There are five criteria, each of which receives two points. Candidates whose writing ability for a criterion is considered to be below the minimum acceptable standard for B1 level receive zero points for that criterion. Candidates whose writing ability is judged to be at the minimum standard for B1 level receive one point for that criterion, while candidates whose ability for a criterion is considered to be above the minimum level for B1 receive two points for that criterion.

The number of points for each criterion is added together to give a total score out of ten.

A successful candidate at minimum B1 level can:

- Can convey simple information of immediate relevance, getting across the point he/she feels to be important
- Can produce continuous writing, which is generally intelligible throughout.
- Can write straightforward connected texts on a range of familiar subjects within his field of interest, by linking a series of shorter discrete elements into a linear sequence.
- Can write personal letters describing experiences, feelings and events in some detail.
- Spelling, punctuation and layout are accurate enough to be followed most of the time.

Writing Descriptors

| Points | Description | Task Completion | Organization | Grammar | Vocabulary | Mechanics |
|--------|------------------------|---------------------------------------|--|------------------------------------|-------------------------------------|--|
| 0 | Below minimum B1 level | Text is often irrelevant to the task. | No beginning or end to the text. Text often jumps. | Very frequent errors often impede. | Lack of vocabulary resources often. | Frequent errors in the spelling of words which may |

| Skema e vlerësimit | | | | | | | | |
|----------------------------|------------------------|---|---|---|--|--|--|---|
| Gjuhë anglishe (Niveli B1) | | Varianti A | | | | | | |
| 1 | Below minimum B1 level | Text is mostly irrelevant to the task. | Text is often irrelevant to the task. | No beginning or end to the text. Text often jumps. | Very frequent errors often impede. | Lack of vocabulary resources often. | Frequent errors in the spelling of words which may | |
| | | The topic is not sufficiently developed and little or no supporting detail is provided. | The topic is not sufficiently developed and little or no supporting detail is provided. | A beginning and end is provided. Topics in the text are sometimes grouped together. | Some connectors are used appropriately. | Errors sometimes occur in basic structures, but only sometimes impede communication. | Vocabulary resources are often used appropriately in convey communication. | Errors may often occur in more advanced vocabulary. |
| | | The topic is fully developed and has appropriate supporting details. | The topic is fully developed and has appropriate supporting details. | Topics are neatly grouped together. Connectors are used appropriately. | Errors in more complex structures may occasionally impede communication. | Some more advanced vocabulary is sometimes used appropriately. | Some more advanced vocabulary is sometimes used appropriately. | Errors are often used appropriately. |

| SKEMA E VLERËSIMIT | | |
|--|--|------------|
| GJUHË ANGLEZE (Niveli B1) | | Varianti B |
| READING SECTION | | |
| <i>For the open-ended questions, answers may be brief or may be written in full sentences. Accept either provided the information in the key is included! Do not take marks off for incorrect grammar or spelling in a longer answer. Do not accept answers which are too long and contain irrelevant information.</i> | | |
| Question | Answer | Points |
| 1 | A | 1 |
| 2 | a) Advertisement 1 / The first advertisement / 1 b) Advertisement 2 / The second advertisement / 2 | 1 |
| 3 | a) Advertisement 1 / The 1st advertisement / 1 b) He / She will correct tests | 1 |
| 4 | a) Advertisement 2 / The 2nd advertisement / 2 b) Advertisement 3 / The 3rd advertisement / 3 | 1 |
| 5 | a) Advertisement 3 / The 3rd advertisement / 3 b) Advertisement 1 / The 1st advertisement / 1 | 1 |
| 6 | C | 1 |
| 7 | A | 1 |
| 8 | a) From Dublin / From Ireland / Dublin b) It is not an easy job. / Not easy / Hard | 1 |
| 9 | a) In the city center b) Her boss | 1 |
| 10 | a) (Because) she has to smile at clients all time and pay attention to what they say. b) Dublin | 1 |
| 11 | a) She couldn't speak Greek / She didn't know a word of Greek b) A musical band / A famous band / A band / Her favourite band | 1 |
| 12 | D | 1 |

| Skema e vlerësimit | | |
|----------------------------|-------------------------------------|------------|
| Gjuhë anglishe (Niveli B1) | | Varianti B |
| USE OF LANGUAGE SECTION | | |
| 13 | C | 1 |
| 14 | B | 1 |
| 15 | D | 1 |
| 16 | C | 1 |
| 17 | B | 1 |
| 18 | A | 1 |
| 19 | C | 1 |
| 20 | C | 1 |
| 21 | D | 1 |
| 22 | a) doing b) Why c) on | 3 |
| 23 | a) nice b) suit c) exactly d) cheap | 4 |
| 24 | a) For b) respect c) so d) before | 4 |

B1 Level Examination Writing Section

The writing section is scored out of a total of ten points. There are five criteria, each of which receives two points. Candidates whose writing ability for a criterion is considered to be below the minimum acceptable standard for B1 level receive zero points for that criterion. Candidates whose writing ability is judged to be at the minimum standard for B1 level receive one point for that criterion, while candidates whose ability for a criterion is considered to be above the minimum level for B1 receive two points for that criterion.

The number of points for each criterion is added together to give a total score out of ten.

A successful candidate at minimum B1 level can:

- Can convey simple information of immediate relevance, getting across the point he/she feels to be important
- Can produce continuous writing, which is generally intelligible throughout.
- Can write straightforward connected texts on a range of familiar subjects within his field of interest, by linking a series of shorter discrete elements into a linear sequence.
- Can write personal letters describing experiences, feelings and events in some detail.
- Spelling, punctuation and layout are accurate enough to be followed most of the time.

Writing Descriptors

| Points | Description | Task Completion | Organization | Grammar | Vocabulary | Mechanics |
|--------|------------------------|---------------------------------------|---|--|---|--|
| 0 | Below minimum B1 level | Text is often irrelevant to the task. | No beginning or end to the text. Text often jumps from topic to | Very frequent errors often impede communication. | Lack of vocabulary resources often impedes. | Frequent errors in the spelling of words which may cause confusion for the |

| | | | | | | | | |
|---|---------------------|---|---|---|--|--|--|---|
| 1 | At minimum B1 level | Text is mostly irrelevant to the task. | Text is often irrelevant to the task. | No beginning or end to the text. Text often jumps from topic to | Very frequent errors often impede communication. | Lack of vocabulary resources often impedes. | Frequent errors in the spelling of words which may cause confusion for the | |
| | | The topic is not sufficiently developed and little or no supporting detail is provided. | The topic is not sufficiently developed and little or no supporting detail is provided. | A beginning and end is provided. Topics in the text are sometimes grouped together. | Some connectors are used appropriately. | Errors sometimes occur in basic structures, but only sometimes impede communication. | Vocabulary resources are often used appropriately in convey communication. | Errors may often occur in more advanced vocabulary. |
| | | The topic is fully developed and has appropriate supporting details. | The topic is fully developed and has appropriate supporting details. | Topics are neatly grouped together. Connectors are used appropriately. | Errors in more complex structures may occasionally impede communication. | Some more advanced vocabulary is sometimes used appropriately. | Some more advanced vocabulary is sometimes used appropriately. | Errors are often used appropriately. |

50 BLOQE NË VIT

“Ne çdo vit kemi bërë një plan që të riparojmë 50 blloqe. Që do të thotë nëse bëjmë 50 blloqe në vit, i bie rreth 200 në gjithë mandatin tonë”

SHESHI I SHQIPTARËVE

“Sheshit Skënderbe është i të gjithë shqiptarëve, nuk është vetëm i qendrës së Tiranës. Në përrurim do kemi shumë shqiptarë që do të vijnë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Greqia”



**VIDEO / ROLFO:
E PAMUNDURA
DO NDODHË NË
BUNK'ARTI**



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

Gjatë dy viteve të ardhshme, investimet e Bashkisë së Tiranës do të shtrihen në nivel kapilar në çdo lagje. Në kuadër të turit “Tirana-2 vjet zgjuar”, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj zhvilloi dje një takim me banorët e njësisë administrative Nr. 11, ku premtoi investime në të gjithë territorin për transformimin e qytetit ndërsa njoftoi dhe hapjen e sheshit “Skënderbej” të shtunën në orën 19:30. Veliaj deklaroi se Bashkia synon që çdo vit të rehabilitojë 50 blloqe banimi. “Një nga fokuset kryesore tani që janë rregulluar gjërat e mëdha, tani që hapet sheshi Skënderbej, tani që hapet Bulevardi i ri, tani që mbaruam me Pazarin e Ri, tani që mbaruam me Parkun Olimpik, na jepet mundësia që ne të fillojmë dhe të punojmë më shumë nëpër lagje. Ne çdo vit kemi bërë një plan që të riparojmë 50 blloqe. Që do të thotë nëse bëjmë 50 blloqe në vit, i bie rreth 200 në gjithë mandatin tonë”, tha Veliaj.

Sheshi Skënderbej hapet të shtunën në orën 19:30

Kryebashkiaku Veliaj ka njoftuar ditën e përrurimit gjatë takimit me banorët e njësisë administrative Nr. 11

KINEMAJA E LAPRAKËS

Kreu i Bashkisë deklaroi se është vetëm çështje kohe dhe përfundimi i punimeve për kinemanë e re të Laprakës e cila do të shërbejë edhe si një qendër komunitare në këtë zonë. “Pak ditë na ndajnë nga hapja. Më në fund do kemi kinemanë moderne në qendër të Laprakës që do jetë edhe

qendër komunitare, përveçse për filmat dhe për argëtimin”, tha ai. Veliaj deklaroi se ajo që është bërë gjatë këtyre dy viteve të para të drejtimit të Bashkisë së Tiranës, është tregues i vullnetit për të transformuar kryeqytetin.

SHESHI “SKËNDERBEJ”

Si shembull konkret, ai

solli ndryshimin që ka pësuar sheshi Skënderbej që është një nga më të mëdhenjtë në rajon. “Një ndër gjërat madhore për të cilat do të doja të bëja një ftesë është hapja e sheshit Skënderbej që do të ndodhë ditën e shtunë, në 19:30. Çdo person e banor i Laprakës është i ftuar në hapjen e sheshit Skënderbej

sepse është sheshi i të gjithë shqiptarëve, nuk është vetëm i qendrës së Tiranës. Do të kemi shumë shqiptarë që do të vijnë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Greqia dhe besoj që do të kemi mundësi që më në fund t’i kthejmë dinjitetin qendrës së qytetit”, u shpreh kryebashkiaku.

NDRYSHIMI

Kreu i Bashkisë deklaroi se gjendja aktuale e Tiranës me atë që ishte më parë është si nata me ditën, kjo falë punës së të gjithë administratës. “Fakti që Bregu i Lumit përmbitej çdo herë që binte shi dhe futej uji në gjithë Laprakën, duke nisur nga zona e Bregut të Lumit e këtej, fakti që ndriçimi ishte bërë si në mesjetë ku shumica e njerëzve as nuk kishin parë një poç të ndezur në shumicën prej rrugicave. Shih, sa shumë punë mund të bëhen kur Bashkia nuk fle gjumë dhe kur e ka mendjen tek puna! Unë besoj se ky slogan që kemi këtë vit quhet “Tirana 2 vjet zgjuar” sepse besoj se secili prej nesh është i ndërgjegjshëm se vetëm kur je zgjuar, mund të bësh punë, po gërhite, po ia fute gjumit, sigurisht plehurat do të bëhen mullar, pusetat s’do i zëvendësojë njeri. Unë dua të falenderoj të gjithë kolegët e Bashkisë që i kanë qëndruar punës tek koka dhe sot flasim për një kategori komplet tjetër problematikash”, theksoi Veliaj.

PROJEKTI / NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS NË BASHKËPUNIM ME FONDACIONIN “LORIK CANA”

Veliaj: Pas kopshteve, tani ndërtojmë fusha sportive për fëmijët

Tirana është qyteti i parë në Shqipëri që nis zbatimin e një programi sportiv për të gjithë fëmijët që frekuentojnë kopshtet publike. Pas rehabilitimit dhe ndërtimit të kopshteve, Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me fondacionin “Lorik Cana”, ka nisur zbatimin e projektit për ndërtimin infrastrukturës sportive në kopshtet publike, me synim masivizimin e pjesëmarrjes në sport për një jetë më të shëndetshme. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, dhe ish kapiteni i kombëtares shqiptare të futbollit, Lorik Cana, morën pjesë në ceremoninë e përrurimit të një prej këtyre fushave sportive në Kopshtin “Xixëllonja” në Tiranë, e vendosur falë donacionit të fondacionit “Lorik Cana”. Kryebashkiaku Veliaj tha se ky është vetëm investimi i parë, i cili do të kontribuojë edhe në edukimin e brezit të ri. “Thirrja e

Lorikut është të vazhdojë të kontribuojë për sportin, ndaj Bashkia e Tiranës iu bashkua nismës së fondacionit “Lorik Cana”, i cili në fakt sot po mbjell filizin e parë të një pune fantastike që ndoshta do ia shohim hajrin disa vite më vonë. Nuk i referohem vetëm futbollistëve të vegjël, të cilët që në moshën 3-4 vjeç mësojnë si të luajnë në skuadër, do mësojnë si të humbasin me dinjitet, do mësojnë edhe si të fitojnë me përlulësi. Këto janë disa karakteristika bazë që shumë prej nesh të rriturve nuk i kemi dhe kur humbasim e trajtojmë si tragjedi, kur fitojmë bëjmë sikur kemi çliruar botën, qoftë kjo në politikë apo në fusha të tjera”, tha Veliaj. Ai shprehu bindjen se falë këtij projekti dhe investimeve që po ndërmer bashkia për përmirësimin e infrastrukturës sportive, Tirana do të fitojë edhe qytetarë të jashtëzakonshëm.



LORIK CANA

Ish-kapiteni i ekipit tonë kombëtar në futboll, Lorik Cana, vlerësoi përkushtimin e kryebashkiakut Veliaj për zbatimin e këtij projekti, i cili do të shtrihet edhe në qytete të tjera të trevave shqipfolëse.

“Është diçka e duhur, që i nevojitet gjithë shoqërisë tonë. Fondacioni do të shtrihet në të gjitha trojet shqiptare, në Shqipëri, në Kosovë dhe shpresojmë në të ardhmen edhe në Maqedoni, për t’ua mundësuar të gjithë fëmijëve tanë, të rriten me vlerat e duhura. Dua të falenderoj Erionin. Ky program ka qenë i vështirë për t’u realizuar dhe zbatuar, por e ndjej veten me fat sepse kisha përballë një person i cili pa folur fare, vetëm me mendime e kupton dhe i ka kuptuar qëllimet që kemi me fondacionin dhe na ka dhënë një mbështetje të jashtëzakonshme”, tha Cana. Në fund kryebashkiaku Veliaj theksoi se ky është një projekt afatgjatë që do të shtrihet edhe në kopshtet e tjera publike, ku krahas infrastrukturës, një vëmendje do t’i kushtohet edhe zbatimit të programit të duhur didaktit dhe pedagogjik. Sipas tij, masivizimi i sportit te brezi i ri,

është garanci për rritjen e tij në mënyrë të shëndetshme, larg basteve dhe kafeneve.

PROJEKTI

Projekti Ka2al (KAZAL) startoi për herë të parë në Hungari në vitin 2010 me 2 projekte pilot. Në vitin 2011, Jenő Buzánszky, legjendari i mbrojtjes së ekipit kombëtar hungarez të futbollit krijoi fondacionin për përfitim publik të fëmijëve të kopshteve për zbatimin e një programi kombëtar sportiv për këtë grupmoshë. Projekti Ka2al në vetvete nuk është vetëm ndërtimi i fushës sportive. Ai përmban fushën, por edhe setin e mjeteve didaktike që do të demonstron më vonë nga fëmijët, dhe metodologjinë e punës me fëmijët. Metodologjia u krijua duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta të moshës së kopshtit dhe përfshin edukimin e mësuesve të kopshteve për disa lloje sporti.

LUFTAPARTIZANE

ANA E ERRET: MOBILIZIME ME FORCË, SEKUESTRIME E DJEGJIE FSHATRASH

ADMIRINA PEÇI
TIRANË

DOKUMENTET EKSKLUZIVE

Mobilizimet me forcë në rradhët e ushtrisë Nacional Çlirimtare, kërcënimet, djegjet e fshatrave, sekuestrimet e pasurive, e shpesh edhe ekzekutimet me gjyqe të dyshimta..

Dy dokumente autentike të vitit 1944, dëshmojnë një anë të shumë diskutuar të viteve të Luftës, polarizimit të skajshëm të marrëdhënieve mes forcave nacionalistë e atyre partizane, të cilat reflektonin edhe në popullin e thjeshtë.

Mobilizimet me forcë në rradhët e ushtrisë nacional çlirimtare, kërcënimet, djegjet e fshatrave, sekuestrimet e pasurive, e shpesh edhe ekzekutimet me gjyqe të dyshimta, shfaqen në një varg dokumentesh sidomos gjatë vitit 1944.

Për lexuesit tanë do të sjellim sot dy dokumente që flasin pikërisht për mobilizimet me forcë, dhe kërcënimet, djegjet e fshatrave të tërë, sekuestrimet e pasurive të fshatarëve etj, vetëm pse nuk kontribuonin për të shtuar rradhët e partizanëve apo nuk jepnin pasuritë e tyre, kafshë e ushqime si kontribut për Ushtrinë Nacional Çlirimtare.

Dokumenti i parë është një letër e Kolë Terovës, ku shkruan për mobilizimet me forcë dhe kërcënimet nga brigadat partizane për sekuestrime e djegie shtëpish për të gjithë ata që refuzonin të luftonin në rradhët e partizanëve, ku një prej viktimave ishte ai vetë.

Ndërsa dokumenti i dytë sjell dëshminë e një qytetari nga Okshtimi i Dibrës, i cili ankohej për sjelljen e Baba Faja Martaneshit dhe forcave të tij partizane. Ky dokument dëshmon gjithashtu edhe për mobilizimin me forcë. Më poshtë i sjellim të plotë këto dokumente bashkë me faksimilet e tyre, zbardhur sipas origjinalit që ruhet në AQSH.

DOKUMENTI I

Letër e Kolë Terovës për Shtabin e Përgjithshëm të UNÇ-së [15 shtator 1944]

SHTABIT NACIONAL ÇLIRIMTAR
Unë i nënshkruari Kola Llazo Terova lindur në katundin Terovë dhe banues prej më shumë se 25 vjet në qytetin Korçë kam nderin t'ju paraqit lutjen që vijon:

Sot më datë 15 Shtator 1944 dhe më ora 12 para dite mu dorëzua këtu në Korçë një letër e dërguarë prej Komandantit të Bataljonit Brig. XV Amdë Babanit të cilën po e përshkruaj tekstualisht si vijon:

“ V. F. L. P. 15/IX/1944 shokut Kostë Tërova”

Për mobilizimin që u bë në Tërovë Këshilla e Katundit Tërovë caktoj edhe për Kollan që të vijë ushtar qoftë se nuk vjen sot do t'ju merret malli bagtija shtëpiaja do tu digjet dhe juve do të shkoni drejt Gjyqit Popullit, shoku Amdë Babani Kom: Bat. Brig. XV.”

gjithashtu me këtë datë mu dorëzua dhe një letër tjetër dërguarë nga shoku Pirro i

cili ndodhet afion prej 2 vjet në katundin Tërovë si vijon:

“Vëllazëria Tërova që kundër kur ka filluarë lëvizja Nazional Çlirimtare e deri sot, familja tuaj nuku e ka ndimuhar luftën sic duhet sa u kemi hequr vërtjeten shumë herë por ju nuku ini bindur mos kujtoni se do ju heqim vërtjeten dhe tjetër herë jo! por do të arestojë dhe do të shkoni të gjykojë pranë Shtabit. Në katundin t'uaj kanë ardhur bataljona partizane, e gjithë fshati ka hequr

baza, i kanë larë, i kanë ndruarë, ju kanë bërë gjithë shërbimet, vetëm shtëpia t'uaj ka qëndruarë e ftohtë karshi luftës t'onë; baza ska hequr, partizanët nuk i ka larë as i ka ndruarë, sa herë janë bërë fushata në bukë e të tjera nuk kini dhënë po ju lajmërojmë që të mos hiqni as një qillo fasule misër grurë, bar prej fshatit t'uaj duhet ta lini në fshat, kështu është urdhëri i Partisë, nuk duhet të

DOKI A DHE DOKI B
Faksimile e letres së Kolë Terovës, ku shkruan për mobilizimet me forcë dhe kërcënimet nga brigadat partizane për sekuestrime e djegie shtëpish për të gjithë ata që refuzonin të luftonin në rradhët e partizanëve

shkojë as një koqe bereqet në shtroftak ku sundun armiku "Nazizmi"; Në qoftë se nuku i përgjigji këtyre fjalëve merren masa të repta, lufta t'onë kërkon ndima njerëzore dhe materiale e jo spektatorë "sehirkhinj 15 /9/1944 të fala Partizane Pirro d. v.”



Po me këtë datë na dërgojë një letër dhe këshilla e katundit Tërovë si vijon:

“Me urdhër të Brigatës XV Këshilla Nazional-çlirimtare e Katundit Tërovë, vendosi mobilizimin e 8 personave midis këtyre 8 u caktua dhe Kola Llazo Tërova, që të shkojë sa ma parë në rradhët e Bataljonit Brigatës XV të kundër shkuanë fshatarët e tij. Në qoftë se nuk i përgjigji kësaj thirrje ju sekuestrohen pasurija, dhe ju digjet shtëpiaja që kini në Terovë”.

Me keq'ardhje Ju njoftojë se një letër e tillë nuku më mbesohej që të vinte nga një Komandant si do mos e adresuarë në një pjesëtar i një familje e cila ka qëndruarë e përpiktë në Ideologjinë e Partisë dhe ka dhënë ndimat ekonomike dhe morale të konsideruëshmenë Partinë; të cilat ndima në rast nevojë munt ti provojmë me dokumenta, gjith'ashtu dhe vëllaj im Kosta në çdo rast që është thëritur në no një mbledhje publike prej autoriteteve të vëdit ka qenë një nga të paktit persona që ka folur kundra ballit duke përklarur Partinë, pa marrë parasysh reziqet dhe kjo provohet në listën që i është dhënë komandës gjermane që t'arestojë, njëkohësisht Ju njoftojmë se dhe në kohën e lëmit kur ndodheshan në katund për të ndimuarë vëllanë t'im kur kryetarët e çetave të ballit rodhë në Katundin Tërovë të cilët përveç që na grabitnë bereqet dhe të holla si neve ashtu dhe katundarët, rekrutuanë me zor 22 djem të Katundit të cilën e konstatova vetë dhe kundërshtova dhe për këtë arsye më goditnë dhe më muarë nënë vërejtje katër dit resht dhe mbasi paguamë një shumë t'hollash më dhanë një lejë për katër dit, dhe kështu unë së bashku me vëllanë t'em u detyrova të largohemi nga Katundi duke lënë gjithë pasurinë në mëshirën e çetave të ballit gati njëzet ditë.

Letra e Komandantit më njofton se unë duhet të paraqitem në Komandën e nalt-përmëndur brenda ditës d. m. th. Brenda një kohe ma pak se 5-6 orëve, dhe në rast të kundërt do të marrë masa ekstreme jo vetëm kundrejt meje por edhe kundra vëllajt t'im Kosta.

Unë e di mirë se deri tash të tilla masa nuku janë marrë kundrejt atyre që kanë qenë armiq të më të fort të Partisë dhe që kanë bërë masakra dhe grabitje popullit pa përjashtim, dhe habitem si Komandanti në fjalë të marrë masa të tilla kundrejt një personi si i nënshkruari pa patur as më të voglin shkak, gjith'ashtu dhe Këshilla e Katundit Tërovë pa patur asnjë të drejtë që të vepërojë dhe të vendosë mi personin tim ka vendosur dhe ka paraqitur listën e vulltarëve ku më ka përbledhur dhe mua pa pyetur dhe pa patur as më të voglin të drejtë mbasi unë nuk mvarem



Çesk Zadeja, koncert me rastin e 90- vjetorit të lindjes

Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit do organizojë concert me kompozime të themeluesit të muzikës shqiptare

Teatrit Kombëtar i Operës dhe Baletit, me rastin e 90-të vjetorit të lindjes së kompozitorit Çesk Zadeja, do organizojë koncertin vokalo-instrumental me kompozime të themeluesit të muzikës shqiptare. Me pjesëmarrjen e korit, orkestrës simfonike të TKOB-së, dirigjent Desir Sulejmani. Koncerti do të zhvillohet në Qendrën Kulturale të Katedrales Ortodokse. Simfonia e parë e vitit 1956, muzika e filmit "Skënderbeu" dhe vepra e fundit për orkestër që Çesk Zadeja e kompozoi më 1996, një vit para se të ndërronte jetë, do luhen në këtë koncert. 90-vjetori i lindjes së Zadesë, festohet edhe si pjesë e kalendarit kushtuar "Historisë së Operës". Zadeja është një nga themeluesit dhe drejtorit artistik i parë i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve, më pas drejtor artistik dy herë i Teatrit të Operës dhe Baletit, krijues i Degës së Kompozicionit dhe Degës së Muzikës në Akademinë e Arteve. Zadeja njihet si kompozitori i simfonisë së parë shqiptare (1956), siç shprehen muzikologët e kohës është vepra më madhore jo vetëm në krijimtarinë e kompozitorit, por edhe në muzikën shqiptare. Krijimtaria e tij ka filluar



Koncerti do të zhvillohet në Universitetin e Arteve, në datë 6 qershor ora 19:00.

herët që në vitet 40 me këngët "Doli nëna në çardak", këngë heroike. Autor i kantatës "Atdheu", krijues i muzikës së filmit të parë shqiptar "Tana" (1958) dhe filmave të tjerë si "Skënderbeu" (1953), "Krevati i Perandori" (1973), "Në kufi të dylegjendave" (1981), "Fla-

ka e maleve" (1982) etj. Në krijimtarinë e tij përfshihen dhe romanca për bas dhe orkestër "Hej ju male", koncert për orkestër piano dhe violinë, suita për orkestër, suita dhe poema vokale, rapsodi për orkestër dhe violinë etj. Ka kompozuar muzikën e baletëve të vëna në skenën e TKOB si: "Delina", (1964), "Shqiponjat sypatrembur", (1972), "Vajzat e qytetit të gurtë", (1990) dhe "Para stuhisë" (1982), e cila pati një premierë të dytë "Lumi i vdekur" 2007. Zadeja ka hedhur bazat e muzikës

së kultivuar shqiptare dhe është një nga themeluesit e institucioneve të Artit si Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore, në vitin 1957. Në vitin '66 dhe më pas në vitin '73 ka mbajtur vendin e drejtorit artistik të TOB si dhe kryetar i degës së muzikës dhe pedagog në Akademinë e Arteve. Shumë kompozitorë që janë bartës të veprimtarive muzikore sot në Shqipëri, janë diplomuar nën drejtimin e kompozitorit Zadeja. Çesk Zadeja u lind më 8 qershor të vitit 1927 në Shkodër.

BERLIN

Karnavalet e Kulturave, kostumet popullore mahnisin vizitorët

Shqipëria u përfaqësua në Karnavalet e Kulturave në Berlin, mes 80 vendeve dhe kulturave të ndryshme që parakaluan në rrugët e qytetit gjerman. Fotot e shqiptarëve, që parakalojnë në rrugët e Berlinit të veshur me kostume popullore kombëtare janë shpërndarë në rrjetin social "Facebook" nga studiuesi dhe albanologu, Robert Elsie. Karnavalet e kulturave në Berlin janë nga karnavalet më të reja në botë dhe janë bërë një nga aktivitetet më popullore dhe më të mirëpritura të qytetit që prej vitit 1996. Ato organizohen çdo vit në fund të pranverës, si aktivitet që feston diver-



sitetin e kulturave në qytet. Kuzhina ndërkombëtare e ushqimi i veçantë, muzika e kërcimit, parada e 80 vendeve dhe kulturave të ndryshme, kanë bërë që Berlinit të jetë në qendër të vëmendjes.

Fondi për 2017-n Ministria hap thirrjen për mbështetjen e krijimtarisë letrare

Në zbatim të politikës së Ministrisë së Kulturës për mbështetjen e autorit shqiptar, hapet për të dytën herë Fondi për mbështetjen e Krijimtarisë Letrare Shqiptare. "Mbështetja e autorit shqiptar ka qenë dhe mbetet një nga përparësitë e politikës së Ministrisë së Kulturës në fushën e librit, duke e vlerësuar autorin si një prej hallkave kryesore të zinxhirit të librit. Suksesi i edicionit të parë të këtij projekti ku u përzgjedhën autorë dhe vepra të rëndësishme, të vlerësuar më pas edhe nga kritika letrare, si "Homo Antarcticus" e Luljeta Lleshanakut apo "Mjaltë në të" e Romeo Çollakut, e shumë të tjerë, jep garanci për një proces të drejtë dhe transparent në ndihmesë të letrave shqipe. Këtë vit, Ministria e Kulturës do t'u japë përparësi krijuesve të rinj, deri 35 vjeç, duke marrë parasysh vështirësitë që ata hasin për t'u evidencuar dhe promovuar në fushën e letrave", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Kulturës në Shqipëri.



Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MËTË LEXUARA DJE

- VIDEO/ Rita Ora e djeg në Tiranë dasmën me vallen e Rugovës
- Kandidatja e PD-së në Vlorë ngatërron "Sheshin e Flamurit"
- Sulmi në Londër, 3 ish ushtarë shqiptarë shpëtojnë 130 klientë
- CV e djalit të Fahri Balliut plot me gabime, kandidon për deputet
- Turpi me Luksemburgun, De Biasi: Kombëtarja ka humbur dëshirën...
- Nga Bledi Mane/Trangull si Babi, pijanec si Mami
- Sadije Berisha publikon foton nga martesja e parë: E virgjër, më gjetën burrë
- Tiranë, gjenden 2 vëllezërit amerikanë, 5 ditë të zhdukur
- PS 71 mandate?Koka:Si në 2009 LSI do e lerë në tentativë puçi
- Djali i Fahriut parkon makinën aty ku u takon atyre me aftësi të kufizuar

LAJMET MËTË KOMENTUARA

- Ndizen tonet PS-LSI,Nikolla:LSI përgjegjëse për shitje diplomash
- "Doni më për Belulin" Kandidati i PD fjalim me lavde vetes
- Përplasja PS-LSI për arsimin Mehmetaj i përgjigjet Ramës
- CV e djalit të Fahri Balliut plot me gabime, kandidon për deputet
- PS 71 mandate?Koka:Si në 2009 LSI do e lerë në tentativë puçi
- Kavajë, Meta vlerëson kandidatin e LSI: CV-ja e tij për t'u pasur zili

VIDEOT MËTË KLIKUARA

Rama:Jo plan bashkëqeverisje me PD e as komplet kundër LSI



Sulmi në Londër, Ambasadori Qirko:S'ka shqiptarë të lënduar

Report Tv e "Piepoli" sjellin të Martën sondazhin e parë të zgjedhjeve




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZHI IDITES

Kush e ka përgjegjësinë për humbjet e njëpasnjëshme të Kombëtares shqiptare

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampioneve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.503 | 331 704
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

Rojet shqiptare heronj të ngjarjeve të Londrës

Ish-ushtarakët shpëtuan jetën e dhjetëra vetëve të strehuar në lokalin ku ata punonin

Mark Stenbridge lavdërohet si hero nga shtypi britanik, pas terrorit në "Urën e Londrës" dhe në "Borough Market". Pronari i një bar-restoranti në këtë lagje të kryeqytetit anglez arriti të shpëtojë 130 vetë nga histeria e agresorëve në rrugë, duke i strehuar në kafenenë e tij. Por Stenbridge sqaron se stafi i vet, gjysma e të cilit janë ish-ushtarakë nga Shqipëria, i kanë tërhequr njerëzit brenda nga veranda e barit, ndërkohë që drejt strukturës janë parë të vraponin personat e armatosur. Stenbridge ia faturon 3 punjonesve të tij shqiptarë meritën e faktit që situata nuk shkoi më keq. "Ishim me fat që pjesëtarë të stafit janë ish-ushtarakë. Ata e ruajtën mjaft mirë qetësinë. Kishim rreth 130 njerëz jashtë në verandë e i tërhoqëm të gjithë brenda. U siguroam që të ishin që të gjithë jashtë rrezikut. Ishin 3 tipa të armatosur jashtë, që erdhën duke bërë titur me të madhe, por hezitan të vepronin, kur panë që ne ishim në njëfarë mënyre të organizuar, e ndërruan drejtim. Ata zbritën poshtë urës duke shkuar drejt një tjetër bari", thotë pronari. Stenbridge u drejtoi edhe një



apel autoriteteve, që pronarët e bareve dhe restoranteve të stërviten më shumë për të tilla situata, ndërsa mendon gjithashtu se në klimën e krijuar, prania policore duhet të jetë më e madhe. Britania është përballur me

3 sulme në 3 muaj dhe në të gjitha rastet, terrorizmi ka goditur ato që njihen si "shënjestra të buta". Disa njerëz, - thonë ekspertët, - kanë filluar ta konsiderojnë këtë lloj dhune si normalitetin e ri, e kjo është pikërisht ajo çfarë

kërkojnë xhihadistët të arrijnë me goditje të tilla të ulëta në mbarë Europën.

TERRORISTËT

Policia londineze i njez identitetet e 3 xhihadistëve, që vranë 7 persona e plagosën

48 të tjerë në Londër, dhe do t'i bëjë publike shumë shpejt. Forcat e rendit bastitën dy shtëpi mëngjesin e së hënës në lindje të kryeqytetit britanik. 12 persona janë arrestuar në zonën "Barking", pas kontrolleve në një

apartament që besohet të jetë përdorur nga njëri prej agresorëve. "Ura e Londrës" është hapur sërish për kalimtarët, së bashku me rrugët rreth e rrotull saj, por masat e sigurisë në zonë mbeten të larta. Viktima e parë e identifikuar nga episodi tragjik i së dielës është shtetësja kanadeze, Chrissy Archibald, e cila ishte zhvendosur në Europë për të qëndruar me të fejuarin.

Mësohet se dy persona e kanë paralajmëruar policinë mbi sjelljen e njërit prej agresorëve, pikëpamjet e të cilit ishin bërë më ekstremiste dy vitet e fundit, gjë që tregon qartë se bëhet fjalë për një njeri që jetonte në Britani, siç po ndodh rëndom tani në Europë, ku aktet terroriste janë duke u kryer më së shumti nga vendas të radikalizuar, apo të frymëzuar prej ideologjisë ekstremiste. Shteti Islamik njoftoi përmes "agjencisë" së vet të lajmeve "Amak" se ata që rikthyen terrorin në kryeqytetin britanik ishin luftëtarë të tij. Në forumet dhe kanalet e tyre të "chat"-it, simpatizantët e Shtetit Islamik shprehën gëzim për këtë sulm, njofton "Site Intelligence Group", i cili është i specializuar për shqyrtimin e propagandës radikale islamike.



GJIRI PERSIK

Gjashtë vende arabe ndërpresin lidhjet me shtetin e Katarit

Gjashtë vende arabe, përfshirë Arabinë Saudite dhe Egjiptin, kanë ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Katarin, duke e akuzuar për destabilizim të rajonit, edhe pse ai vet e quan vendimin e tyre "të pajustificuar e krejtësisht të pabazë". Pretendimet e këtyre shteteve, ku futen edhe Bahreini, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jemeni dhe Libia, janë mjaft të ashpra. Katari, sipas tyre mbështet grupet terroriste, përfshirë Shtetin Islamik.




Agjencia shtetërore saudite e lajmeve "SPA" thotë se, Rijadi ka mbyllur kufijtë dhe kontaktet tokësore, detare e ajrore me Katarin, duke e izoluar gjerësisht.

Zyrtarët vendas citohen prej saj të pohojnë se, një masë e tillë merret për mbrojtjen e sigurisë kombëtare nga rreziqet e terrorizmit dhe të ekstremizmit. Vizitorëve dhe rezidentëve nga Katari u janë dhënë dy javë kohë për t'u larguar nga këto vende, e Doha është përjashtuar edhe

nga koalicioni i drejtuar prej sauditëve që lufton në Jemen. Lëvizja e paprecedentë ka sjellë përçarjen më të fortë mes shteteve të fuqishme të gjirit. Aleatët e ngushtë të Uashingtonit e kanë përdorur me kohë fuqinë e tyre financiare dhe politike për të ndikuar ngjarjet në Libi, Egjipt, Siri, Irak e Jemen. Mosmarrëveshjet vijnë dy javë pasi të njëjtat vende bllokuan "site"-t e lajmeve të Katarit, ku ishin shfaqur "online" kritikant e rrepta të emirit Al Thani

kundër Arabisë Saudite. Qeveria e atjeshme pretendon se, faqet zyrtare të saj janë vjedhur nga "hacker"-a, por disa raporte tregojnë se komentet që godisnin edhe presidentin amerikan Trump mund të kenë qenë të vërteta. Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson, dhe ai i Mbrojtjes, James Mattis deklaruan se nuk presin që ky vendim të ndikojë mbi luftën kundër terrorizmit, por sërish i nxisin vendet në fjalë që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet mes tyre.



"THE GUARDIAN"

Moska është përjekur të destabilizojë Ballkanin

"Agjentët dhe diplomatët rusë janë përjekur prej gati një dekadë të përhapin propagandën e Moskës e të shkaktojnë destabilizim në Ballkan, e sidomos në Maqedoni", shkruan "The Guardian", duke cituar për këtë pohim të saj, dokumente sekrete të shërbimit rus të inteligjencës, të cilat kanë rënë në duart e gazetës prestigjioze. Dokumentet u zbuluan fillimisht nga Organizata Botërore për Raportimin e Korrupsionit (OCCRP), që e ka ndarë më

pas informacionin me "The Guardian". Gazeta shkuan se këto dosje dokumentojnë faktin që shërbimi sekret rus, në bashkëpunim me serbët, ka punuar në mënyrë aktive për destabilizimin e rajonit. Fokusi shumëvjeçar i tyre ka qenë në mënyrë të veçantë Shkupi, ku sipas transkripteve të botuara nga e përditshmja britanike, prej vitesh po punohet me metoda të ulëta që të krijohet konflikt etnik dhe politik, me qëllimin të vonohet anëtarësimi i Maqedonisë në NATO.

Dokumentet tregojnë se Moska i ka shtuar tentativat për ndikim në shtetet e ish-Jugosllavisë. Qëllimi kryesor i Kremlinit është të ndalohet bashkimi i këtyre vendeve me aleancën atlantiko-veriore dhe të mbahen sa më larg ndikimit të Perëndimit. Aty tregohen edhe përpjekjet e inteligjencës serbe për të mbështetur nacionalistët proruse dhe antiperëndimorë në Maqedoni. Operacionet për rritjen e ndikimit rus nisën në vitin 2008, kur Greqia bllokoi përpjekjet e Shkupit për anëtarësim në NATO, pas mosmarrëveshjeve të emrit. "Kremlini, - thuhet në njërin prej dokumenteve të zbuluara nga shërbimet maqedonase të inteligjencës, - synon të kontrollojë burimet strategjike të energjisë përmes partneritetit me shtetet e Ballkanit dhe kërkon po kështu ta kthejë Maqedoninë në varësinë e tij". Dosjet tregojnë edhe sesi funksionon rrjeti i agjenturës. Tri agjentë të shërbimit të jashtëm sekret rus "SVR" janë të vendosur në Shkup dhe mbikëqyren nga stacioni i këtij shërbimi në Beograd. Ambasada e Rusisë në Maqedoni ka në radhë e saj 4 agjentë të "GRU"-së, agjencia ushtarake ruse e inteligjencës. Veprimet e tyre koordinohen nga baza e "GRU"-së në Sofje.

Bashkimi Evropian Bllokohen përkohësisht hyrjet e reja në Eurozonë

Pas tronditjes nga themelet, që u shkaktua nga kriza financiare dhe problemet me Greqinë, udhëheqësit e Eurozonës po tregohen të kujdesshëm me zgjerimin e saj. Komisioni European dhe Banka Qendrore Europiane janë duke i verifikuar me shumë kujdes, vendet që duan të bëhen pjesë e unionit monetar, kriteret e rrepta të të cilit nuk përbushen aktualisht nga asnjë prej shteteve candidate: Bullgaria, Çekia, Kroacia, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Suedia. Debati i madh përqëndrohet te fakti se,

kushtet nuk i plotësojnë që të gjitha as vet disa prej vendeve tashmë anëtare të zonës së monedhës së përbashkët.

Komisioneri i BE-së për Financat, Pierre Moscovici mendon se, deri në vitin 2025, pjesë e Eurozonës duhet të jenë bërë të gjithë anëtarët e bllokut evropian. Kjo i qetëson disi aspiruesit, që shpresojnë nga reformat e reja dhe ndihma për aderimin. Bullgaria uron të ketë ndihmën e Gjermanisë, Rumania është në pritje dhe ka hequr dorë zyrtarisht nga qëllimi që të anëtarësohej deri në vitin 2019.

UEFA shpall skuadrën e vitit, 8 nga Reali, 3 nga Juve

Fituesit e Champions dominojnë formacionin e më të mirëve dhe më pas vijnë finalistët

Dy ditë pas triumfit madrilën në Kardif, UEFA ka publikuar edhe skuadrën e vitit në Champions League. Mes 18 lojtarëve "të grumbulluar" janë dy portierë, 5 mbrojtës, 6 mesfushorë dhe 5 sulmues, mes të cilëve 8 janë nga Reali dhe 3 nga Juventus. Sigurisht që nuk mungojnë edhe lojtarë të Atletico Madrid apo disa skuadrave të tjera, si Mbatpe apo Lewandowski. UEFA e ka shoqëruar përzgjedhjen e saj edhe me motivimet përkatëse të mbikëqyrësve teknikë. Sa i përket portës, Buffon mbetet një simbol i vërtet i "Zonjës së vjetër" dhe performancat e tij sigurisht që janë ndër më të mirat, pavarësisht finales ku pësoi 4 gola. Zëvendës i tij është Oblak i Atletico, një portier me shumë kualitete, gjë që është vërtetuar falë pritjeve të panumërta të tij. Në mbrojtje nuk mund të mungonin Carvajal dhe Marcelo, dy anësorët e Realit, me spanjollin që është përmirësuar nga ndeshja në ndeshje dhe brazilianin që ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për formacionin "merengues". Mbi të gjithë është Sergio Ramos, kapiten dhe udhëheqës i kampioneve të rikonfirmuar të Europës, edhe pse për këtë ka disa "vërejtje" për disa sjellje josportive në fushë. Në shoqërinë e tij vihet padyshim Bonucci i Juventusit, një nga shtyllat fundamentale të repartit të tërhequr të bardhezinjve. Një lojtar me vizion të qartë dhe me pasime tepër të sakta. I pesti, por jo më pak i rëndësishëm është Godin i Atletico, një lojtar me kontribut të shquar të "Los Colchoneros", por edhe ai me më shumë përfaqësime. Edhe mesfusha dominohet nga madrilenët, me Casemiron që shquhet për ekuilibrin që i ka dhënë repartit të mesfushës të Real, por edhe për golat e rëndësishëm që ka shënuar. Toni Kroos është tejet i sigurt në zotërimin e topit dhe gjendet gjithmonë në vendin e duhur dhe kohën e duhur. Modric vlerësohet për shpejtësinë e tij në manovrim dhe kontributin që jep në fazën ofensive të skuadrës, duke ruajtur kështu një ritëm tejet të lartë për Realin. Isco është mesfushori sulmues i konsideruar perfekt, di të driblojë, të pasojë, por edhe të shënojë nga çdo zonë e fushës. I vetmi juventin që përfshihet



këtu është Pjaniç, një lojtar vendimtar për ecurinë e "Zonjës së vjetër", kualitetet e të cilit vihen re në zonën më të tërhequr të mesfushës, me kontribut të madh për mbrojtësit. Këtu përfshihet edhe Bakayoko i Monakos, një lojtar që ishte shtylla e mesfushës së një skuadre të jashtëzakonshme për këtë vit në Principatë. Sulmi është thuhajse i zaptuar prej vitesh, kryesisht nga Cristiano Ronaldo dhe Messi. Që të dy pretendentët të vazhdueshëm për "Topin

e Artë", me portugezin që shpallet kryegolashënues për të pestin vit radhazi, por që ishte edhe më i miri në fushë në finalen e Kardifit. "Pleshti" i katalanasve është golashënuesi i dytë më i mirë, shpikës i golave nga më të pamundurit, por edhe asistues për shokët e tij të skuadrës. Nuk mund të lihej jashtë Griezmann i Atletico, golat e të cilit e çuan aq larg ekipin e dytë madrilën. I aftë me kombinimet, por edhe shpërthimet, shembull për të gjithë sulmuesit. Ai që në fakt

është risi e këtij formacioni është Mbatpe, por kjo është mëse e merituar pas performancave të jashtëzakonshme me Monakon, ku vlerësohet si i riu më i mirë i një skuadre plot me të rinj. Nuk di të ndalet së shënuari, edhe pse goli ndaj Joves nuk ishte i mjaftueshëm për ta çuar skuadrën në finale. Por është edhe një sulmues tjetër, Lewandowski i Bayern Munchen, efikas si gjithmonë. Nëse Bayern është një ekip i frikshëm, një meritë e veçantë i takon polakut.

JUVENTUS

Allegri mes qëndrimit dhe milionave të PSG

Rikompozim i Juventusit. Trajneri i bardhezinjve Massimiliano Allegri është realist, por ashtu njësoj si pjesa më e madhe e mbështetësve të "Zonjës së vjetër" edhe ai e kishte përkëdhelur idenë e fitimit të Champions League, pavarësisht faktit se ishte i vetëdijshëm për diferencën jo të vogël mes dy skuadrave. "Do të qëndroj tek Juve dhe do të tentojmë sërish vitin e ardhshëm", kështu u shpreh Allegri pas përfundimit të ndeshjes. Tekniku 49-vjeçar është një njeri ambicioz dhe dëshiron shumë të bëjë një tentativë të fundit, por më parë duhet të ulet në tavolinë me drejtuesit dhe të bisedojë me ta për të ardhmen. Përcaktimi i objektivave për sezonin e ardhshëm, me Championsin si objektivi primar, por dhe rinovimi kontratës. 5 milionë Euro përfiton momentalisht tekniku dhe pritet një vendim nga ana e tij




deri ditën e Mërkur, ditë në të cilën do të ketë dhe një takim me drejtorin e përgjithshëm Beppe Marotta. Në krahun e tjetër e pret Psg me një ofertë faraonike prej 10 milionë Eurosh në sezon. Nuk mbaron me

kaq. Në radhët e bardhezinjve pritet dhe një rikompozim i mbrojtjes. 98 vjeç është reparti i prapavijës së Juventusit. Leonardo Bonucci në një postim në Instagramin e tij shprehej se nuk e mohon zhgënjimin dhe se ndihet krenar që ishte pjesë e këtij grupi futbollistësh. Pak a shumë një lamtumirë e mbrojtësit. Dihet tashmë se shumë skuadra të mëdha e duan 30-vjeçar, mes tyre Chelsea, Man.City dhe Reali i Madridit. E ardhmja? Shumë shpejt do të merret vesh. Andrea Barzagli dhe Gigo Cheillini do të jenë edhe për sezonin e ardhshëm. Kontrata e tyre skadon me 2018, por edhe këta kanë peshën e tyre të fajt. Rugani ende nuk është i përgatitur për ndeshje të një nivel të lartë, Benatia nuk është Sergio Ramos. Në mesfushë gjithashtu ndoshta nevojitet dicka e re. Rikompozimi i skuadrës tashmë duket i pashmangshëm.

Mbrojtësi

E ardhmja e Ajetit mund të jetë Bologna

Bologna mund të bëhet streha e disa futbollistëve të kombëtares shqiptare për sezonin e ardhshëm në Serinë A. Dihet prej disa kohësh interesi i klubit abruzez për Ledian Memushajn, i cili pritet të largohet nga Pescara tashmë e rënë në Serinë B. Së fundmi skuadra që e mbylli kampionatin në vendin e 15-të po studion mundësinë për të siguruar edhe shërbimet e Arlind Ajetit. Mbrojtësi 23-vjeçar pritet të largohet nga Torino, ku është ektivizuar në vetë, 4 ndeshje të Seria A për një total prej 250 minutash e nga kjo situatë kërkon të përfitojë Bologna, që synon të përforcohet në të gjitha repartet për sezonin e ardhshëm. Sipas Corriere Dello Sport pavarësisht faktit se Ajeti nuk ka mundur ta bindë Mihajloviçin për vendin e titullarit, te Bologna shihet si futbollist i prespektivës për moshën e re por edhe faktit që është pjesë e Serisë A prej dy sezonesh. Ajeti aktualisht është u grumbulluar me kombëtaren për ndeshjen eliminatorie me Izraelin në transferë, ndërkohë që nuk u aktivizua nga De Biasi në miqësore e humbur me Luksemburgun.



KOMBETARJA

Stërvitje me grup të reduktuar pas humbjes

Dita pas humbjes ndaj Luksemburgut reflektohet në fytyrat e lojtarëve të Kombëtares Shqiptare të cilët zbarkuan në kompleksin stërvitor në Luksemburg për seancën e fundit stërvitore në këtë vend. Grupi i reduktuar dhe dukshëm i zhgënjyer për atë disfatë u shfaq gjatë orëve të paradites të së martës në kompleks. Vetëm një pjesë e organizatës zhvilloi fillimisht disa ushtrime me top dhe sipasa asaj që raportoi Supersport, seanca u drejtua nga zëvendësi i De Biasit, Marco Veronese. Pjesa tjetër e skuadrës qëndroi në hotelin e Kombëtares për të zhvilluar seanca të lehta stërvitore pas ngarkesës së madhe fizike që mori në sfidën miqësore të Luksemburgut. Tashmë ndalesa e radhës për kuqeziqet do të jetë Turqia, aty ku De Biasi dhe të besuarit e tij do të përgatisin ndeshjen zyrtare kundër Izraelit.



NA VIZITONI



BUNK'ART 2

**EKSPOZITA VIDEO-MUZEALE BRENDIA ISH-BUNKERIT
ANTI-BËRTHAMOR I MINISTRISË SË BRENDSHME**

www.bunkart.al / info@bunkart.al

**HAPUR ÇDO DITË:
10:00 deri 20:00**



**Prenotime:
+355 (0) 67 20 72 905**

**RR. "ABDI TOPTANI"
PRANË MINISTRISË
SË BRENDSHME-TIRANË**

